



1

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E DREJTËSISË - MINISTARSTVO PRAVDE - MINISTRY OF JUSTICE

Drejtoria Qendrore / Central Service / Korrektivna Sluzba KOSOVA  
KOSOVO CORRECTIONAL SERVICE

Njësia org/Org.Jediniца/Org.Unit:  
CS Nr./Dr./No.: 0215 Data/Datum/Date: 22/02/22

Shënimi/Dodaci/Annex: \_\_\_\_\_


PRISHTINËJA



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice**

Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Correctional Service  
**Drejtoria Qendrore-Prishtinë**



**Raporti Vjetor, 2021**

**Janar 2021**

# SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS

## Raporti Vjetor, 2021

Shërbimi Korrektues i Kosovës, 2021

Publikuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

---

Janar 2021

**SHKURTESAT**

SHKK-Shërbimi Korrektues i Kosovës;

QK-Qendra Korrektuese;

QP-Qendra e Paraburgimit;

BSL-Burgu i Sigurisë së Lartë;

QKFL-Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan;

IKSHPK-Instituti kombëtar i shëndetësisë publike të Kosovës;

MASHT-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;

ICITAP- Departamenti Amerikan i Drejtësisë, Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnime në Hetimet Penale;

INL-International Narkotik Law.

AAPSK-Agjencioni i Administrit të Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar

## Përmbajtja

<b>Pjesa e Parë</b> .....	7
<i>Përmbledhja ekzekutive</i> .....	7
<i>Misioni</i> .....	8
<i>Mandati</i> .....	8
<b>Pjesa e Dytë</b> .....	9
<i>Vështrim i Përgjithshëm</i> .....	9
<i>Transparenca</i> .....	10
<b>Pjesa e Tretë</b> .....	11
<i>Përmisimi i kushteve të infrastrukturës për akomodim të burgosurve</i> .....	11
<i>Projektet që janë realizuar</i> .....	11
<b>Pjesa e Katërt</b> .....	16
<i>Siguria</i> .....	25
<i>Monitorimi i dukurive specifike/radikalizimi në burgje</i> .....	25
<i>Njësitë për përcjelljen e të burgosurve</i> .....	26
<b>Pjesa e Pestë</b> .....	27
<i>Çështjet Ligjore</i> .....	27
<i>Hartimi i Projektligjeve dhe rregulloreve</i> .....	27
<i>Udhëzimet Administrative të miratuara</i> .....	27
<i>Rregulla të brendshme të miratuara</i> .....	27
<i>Kërkesa për faljen e dënimit</i> .....	27
<i>Kërkesa për pezullim të ekzekutimit të dënimit</i> .....	27
<i>Kërkesa për transferim dhe ekstradim</i> .....	28
<i>Zbatimi i Politikave strategjike shtetërore</i> .....	29
<b>Pjesa e gjashtë</b> .....	30
<i>Burimet Njerëzore</i> .....	30
<i>Transferet e zyrtarëve</i> .....	31
<i>Masat disiplinore ndaj personalit të Shërbimit Korrektues të Kosovës</i> .....	31
<i>Zhvillimi profesional i stafit</i> .....	32
<b>Pjesa e shtatë</b> .....	34
<i>Pilot projektet për Themelimin dhe Funkcionalizimin e Mekanizmave</i> .....	34
<i>Qëllimi i Projektit të Njësisë së Intelejencës</i> .....	34



<i>Vlerësimi dhe Klasifikimi i të Burgosurve</i> .....	34
<b>Pjesa e tetë</b> .....	35
<i>Trajtimi/Risocializimi dhe përgatitja për riintegrim</i> .....	35
<b>Pjesa e nëntë</b> .....	36
<i>Institucionet korrektuese</i> .....	36
<i>Arsimimi i të burgosurve</i> .....	37
<i>Regjistrimi i nxënësve sipas paraleleve të ndara të shkollave amë për vitin shkollor</i> .....	37
<i>Programet trajnuese në institucionet korrektuese</i> .....	37
<i>Programet rehabilituese</i> .....	38
<i>Aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me rehabilitimin e të burgosurve</i> .....	39
<i>Punësimi i të burgosurve në institucionet korrektuese</i> .....	40
<b>Pjesa e dhjetë</b> .....	42
<i>Njësia Ekonomike në Institucionet Korrektuese</i> .....	42
<b>Pjesa e njëmbëdhjetë</b> .....	48
<i>Prokurimi</i> .....	48
<b>Pjesa e dymbëdhjetë</b> .....	49
<i>Teknologjia informative/TI në SHKK</i> .....	49
<b>Pjesa e trembëdhjetë</b> .....	51
<i>Menaxhimi i Parasë Publike/Buxhetit të SHKK-së</i> .....	51
<b>Pjesa e katëmbëdhjetë</b> .....	53
<i>Bashkëpunimi dhe Kordinimi</i> .....	53
<i>Marrëveshjet e bashkëpunimit</i> .....	53
<i>Bashkëpunimi ndërmjet SHKK-së</i> .....	54
<i>Projektet e jashtme për mbështetjen e SHKK-së</i> .....	54
<b>Pjesa e pesëmbëdhjetë</b> .....	60
<i>Statistika</i> .....	60
<i>Pranime</i> .....	60
<i>Lirimet</i> .....	61
<i>Pushimet e të dënuarve jashtë institucionit korrektues</i> .....	63
<i>Statistika e gjetjeve dhe parandalimit të gjërave të ndaluara në institucione korrektuese</i> .....	64
<i>Statistika e gjetjes së kontrabandës në sasi</i> .....	64
<i>Incidentet në Institucione korrektuese</i> .....	64
<i>Grevat e urisë</i> .....	65
<i>Instituti i Psikiatrisë Forenzike-IPFK</i> .....	65

Pjesa e gjashtëmbëdhjetë.....	67
<i>Përkujdesja shëndetësore.....</i>	<i>67</i>
Pjesa e shtatëmbëshjetë.....	68
<i>Menaxhimi i Pandemisë në Institucionet Korrektuese.....</i>	<i>68</i>
Sfidat e viti 2021.....	70

## I. PJESA E PARË

Përmbledhje ekzekutive Raporti i Punës për vitin 2021 paraqet aktivitetet dhe veprimtarinë e zhvilluar njëvjeçare të Shërbimit Korrektues të Kosovës në kuadër të realizimit të vizionit dhe mandatit kushtetues dhe ligjor, si institucion i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta.

Ky raport përbëhet nga pjesë të standardizuara të realizimit të punëve gjatë vitit 2021, të cilat pasqyrojnë aspekte të veçanta për Shërbimin Korrektues të Kosovës, me ç' rast në pjesën e parë apo hyrëse janë paraqitur misioni, mandati, fushëveprimi për Shërbimin Korrektues të Kosovës, kurse në pjesën e dytë, vështrimi i përgjithshëm dhe transparenca.

Raporti Vjetor i Punës për vitin 2021 i Shërbimit Korrektues të Kosovës, në pjesën tretë, përmban të dhëna të çmueshme për përmasimin e kushteve të infrastrukturës për akomodim të burgosurve.

Në pjesën e katërt të këtij raporti pasqyrohet siguria në institucionet korrektuese të Shërbimit Korrektues të Kosovës, monitorimi i dukurive specifike/radikalizmi në burgje, si dhe Njësiti për Përcjelljen e të Burgosurve, kurse në pjesën e pestë janë paraqitur çështje ligjore si hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore (udhëzimet administrative dhe rregullat e brendshme, vendimet), projektligjet, zbatimi i politikave strategjike shtetërore.

Në pjesën e gjashtë është paraqitur, aktivitetet e Shërbimit Korrektues të Kosovës, si: rekrutimi, transferimi dhe avancimi i personelit të SHKK-së dhe zhvillimi profesional i stafit.

Gjithashtu në pjesën e shtatë janë pasqyruar pilot projektet për themelimin dhe funksionalizimin e mekanizmave si: Njësia e Inteligjencës, Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve.

Në pjesën e tetë është paraqitur përkushtimi i Shërbimit Korrektues të Kosovës në Trajtimin/risocializimin dhe përgatitjen për riintegrim të personave të burgosur. Gjithashtu, në vijimësi të pjesës së nëntë prezantohen institucionet korrektuese aktivite që zhvillohen në kuadër të tyre, si: arsimimi i të burgosurve, regjistrimi i nxënësve sipas paraleleve të ndara të shkollave amë për vitin shkollor, programet trajnuese, programet rehabilituese, aktivite tjera që kanë të bëjnë me rehabilitimin e të burgosurve, si dhe punësimin e të burgosurve në institucione korrekturës, në pjesën e dhjetë është paraqitur Njësia Ekonomike në institucionet korrektuese, statistikat dhe kalkulimet e shpenzimeve dhe të kursimeve. Në pjesë e njëmbëdhjetë, Prokurimi, planet dhe aktivitetet; në pjesën e dymbëdhjetë, Teknologjia informative në SHKK-së, Në pjesën e trembëdhjetë menaxhimi i parasë publike/buxheti i SHKK-së, gjithashtu në pjesën e katërbëdhjetë bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet partnere-marrëveshjet e bashkëpunimit, projektet e jashtme për mbështetjen e SHKK-së. Pjesa e pesëmbëdhjetë janë paraqitur statistika si: Lirime, pranime, beneficionet e të dënuarve, statistikat e gjetjeve dhe parandalimit të gjërave të ndaluara në institucione korrektuese, në pjesën e gjashtëmbëdhjetë përkujdesja shëndetësore në institucionet korrektuese. Ndër të tjera, në këtë dokument të



rëndësishëm në pjesën e shtatëmbëdhjetë prezantohet menaxhimi i pandemisë Covid-19 në institucionet korrektuese dhe urdhrat operativ të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së.

## **1.Misioni**

Shërbimi Korrektues i Kosovës, në bashkëpunim me të gjithë partnerët e Drejtësisë dhe në përshtatshmëri të vazhdueshme me ligjet bazë në Kosovë, synon të korrektojë dhe risocializojë të burgosurit duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa diskriminim, si dhe siguron një ambient të sigurt për stafin, të burgosurit dhe kontribuon në sigurinë e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

## **2.Mandati**

Mandati i Shërbimit Korrektues të Kosovës është përkufizuar me aktet ligjore përkatëse në fuqi. Sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Shërbimi Korrektues i Kosovës është Organ Qendror i Administratës Shtetërore, profesional i pavarur, i uniformuar me grada dhe pjesërisht i armatosur në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë së Drejtësisë. Fushëveprimi i tij është risocializimi i personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit dhe ri integrimin e tyre në shoqëri duke kryer një detyrë me rëndësi në parandalimin nga përsëritja e veprave penale dhe parandalimi i kriminalitetit për të ardhmen.

### **Fushëveprimi sipas Ligjit:**

- Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm;
- Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e burgimit të të miturve dhe masave edukuese/korrektuese, përveç nëse Kodi i Drejtësisë për të Mitur e parasheh ndryshe;
- organizimin e programeve që i kontribuojnë korrektimit, përgatitjes për lirim dhe mbikëqyrjes afatgjatë të personave të dënuar me burgim dhe me burgim të përjetshëm;
- Vlerësimin e rrezikut kriminogjen dhe për caktimin e nevojave për trajtim të kryerësve të veprave penale;
- Udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar në përfundim të dënimit të tyre;
- Ndërmarrjen e masave me qëllim të arsimimit dhe aftësimin profesional të personelit civil dhe të zyrtarëve korrektues të punësuar;
- Realizimin e bashkëpunimit me institucionet përkatëse, shoqatat dhe organizatat te cilat merren e çështjen e monitorimit e te drejtave te të burgosurve.

## II.PJESA E DYTË

### VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Përpos faktit që Drejtoria Qendrore e SHKK-së ka përmbush përgjegjësit e saj gjatë vitit 2021 duke mbikëqyr ligjshmërinë e punës dhe të veprimit të njësisë organizative të Shërbimit Korrektues dhe të institucioneve korrektuese me të cilën udhëheqë Drejtori i Përgjithshëm, i cili drejton dhe kontrollon të gjitha çështjet lidhur me Shërbimin Korrektues, për më tej:

Shërbimi Korrektues i Kosovës, ka ushtruar përgjegjësitë e saj me integritet, duke u bazuar në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, aktet nënligjore, rregullat e brendshme, legjislacionin tjetër në fuqi, standardet ndërkombëtare, si dhe prioritetet e planit të punës së SHKK-së.

Shërbimi Korrektues i Kosovës gjatë kësaj periudhe të vitit 2021, ka arritur të kryej një varg aktivitete të fushëveprimit të saj dhe sipas vlerësimit ka shënuar progres në përmbushjen e objektivave të punës, si dhe ka qenë transparent për mënyrën e ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësi që kemi ndaj të burgosurve, stafit dhe publikut.

Shërbimit Korrektues i Kosovës me kapacitetet e tij të burimeve humane është angazhuar intenzivisht me përkushtim maksimal profesional për të përmbushur misionin për risocializimin e personave që kanë rënë ndesh me ligjin, duke mbikëqyrur ligjshmërinë e punës për ngritjen e cilësisë të trajtimit, respektimin e dinjitetit njerëzor dhe të drejtat fundamentale të personave të privuar nga liria, përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës dhe akomodimit në kuadër të mundësive buxhetor dhe me mbështetje nga donatorët si partner strategjik të SHKK-së.

Shërbimi Korrektues i Kosovës edhe këtë vit është ballafaquar dhe sfiduar me një situatë të paplanifikuar, e që ka qenë situata e pandemisë **Covid-19**. Përballë kësaj situatë të paraqitur në gjithë Kosovën edhe Shërbimi Korrektues i Kosovës ka përdorur kapacitetet e burimet njerëzore dhe financiare për të menaxhuar sa ma mirë këtë situatë, duke zbatuar masat parandaluese sipas vendimeve të Qeverisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe IKSHPK-së, si dhe janë nxjerr urdhra operative të vazhdueshëm në përputhje me situatën.

Situata me Covid-19, ka imponuar që të pezullohen përkohësisht disa drejta dhe beneficone për të burgosur, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të burgosurve dhe stafit në institucione korrektuese dhe në anën tjetër është mundësuar një mënyrë tjetër për komunikim të rregullt për të burgosur me familje e tyre përmes Skype.



Ndër prioritetet kyçe i realizuar ka qenë iniciimi i nxjerrjes së një Ligji të veçantë për Shërbimin Korrektues të Kosovës që nuk ka ekzistuar deri më tani përmes të cilit do të rregullohet statusi dhe veprimtaria e Shërbimit Korrektues të Kosovës duke e transformuar në Agjenci ekzekutive të sigurisë me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe lehtësimin e funksionimit më efikas të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Shërbimi Korrektues i Kosovës në bashkëpunim me partnerët vendor dhe ndërkombëtar, si dhe me Ministrinë e Drejtësisë ka arritur që të finalizoj Projektligjin e Shërbimit Korrektues të Kosovës, i cili është në procedurë të mëtejme të miratimit nga institucionet kompetente të Republikës së Kosovës.

Drejtori i Përgjithshëm ka përfaqësuar Shërbimin Korrektues të Kosovës në të gjitha proceset brenda dhe jashtë vendit.

Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm, Drejtoria Qendrore dhe të gjithë sektorët e saj, si dhe drejtorët e institucioneve korrektuese në kuadër të përgjegjësisë, kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme për të arritur objektivat e parapara për vitin 2021.

### **3. Transparenca**

Me qëllim të rritjes së transparencës, ngritjen dhe forcimin e imazhit, Shërbimi Korrektues i Kosovës ka qenë dhe vazhdon të jetë i përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, mediat elektronike dhe ato të shkruara.

Gjatë vitit 2021 janë realizuar 85 përgjigjeje në kërkesa të mediave, me leje të SHKK-së nëpër qendrat korrektuese janë realizuar 35 storje dhe intervista televizive, janë publikuar 170 komunikata me shkrim për media, të njëjtat janë publikuar në web faqen dhe në rrjetet sociale të SHKK-së.

### III.PJESA E TRETË

#### PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË INFRASTRUKTURËS PËR AKOMODIM TË BURGOSURVE

Shërbimi Korrektues i Kosovës përmes Divizionit të Inxhiringut ka për qëllim që hapësirat e populluara apo të banueshme nga të burgosurit dhe stafit punues t'i ofrohen apo përmirësoheni kushtet e jetës dhe punës, si dhe në përputhje me normat ndërkombëtare, të përmirësohen kushtet hixhieniko-sanitare, krijimin e një ambienti sa më të përshtatshëm për punë, jetë dhe akomodim për të burgosur, personel me kushte sa më të përshtatshme, të sigurta si për të burgosurit ashtu edhe për stafin.

#### 4.Projektet që janë realizuar

Projektet kapitale janë realizuar disa me punën e të burgosurve (renovimet, instalimet etj), e disa nga kontraktuesit kurse materiali është furnizuar nga kontraktuesit të cilët në kontratë kishin vetëm furnizim me material.

Gjatë vitit 2021 projektet e monitoruara drejtpërdrejte nga zyra e Inxhinjeringut kane qenë investime të shpërndara nëpër të gjitha Burgjet dhe Qendrat e Paraburgimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

*Tabela nr.1 Projektet e Realizuara*

Emri i Projektit	Qendra
Renovimi i Brendshëm i Portës së re në Q. K. Dubrave	Qendra Korrektuese Dubravë
Instalimi i ujëmatësve digjital ne sistemin e ujësjellësit ne Q. K. Dubrave	Qendra Korrektuese Dubravë
Renovimi i brendshëm i Kuzhinës	Qendra Korrektuese Smrekovnicë
Renovimi i brendshem i kuzhinës në objektin e administratës në Q.K.Dubravë	Qendra Korrektuese Dubravë
Ndarja e hyrjës për vizitor në QP.Gjilan	Qendra e Paraburgimit Gjilan
Ndarja e hyrjës për vizitorë dhe stafin në Q.P.Gjilan-faza II	Qendra e Paraburgimit Gjilan

**Janar 2021**

Rrethimi i shëtitoreve me tel në QP.Prishtinë	Qendra e Paraburgimit Prishtinë
Rrethimi i shëtitoreve me tel në QP.Gjilan	Qendra e Paraburgimit Gjilan
Instalimi i bravave- rrezeve të dorës në Burgun e Sigurisë së Lartë	Qendra e Paraburgimit Prishtinë
Furnizimi me material esencial elektrik për institucionet korrektuese	Institucionet Korrektuese
Furnizimi me material esencial elektrik për SHKK- furnizimi II	Institucionet Korrektuese
Ndarja e hyrjes për vizitorë dhe staf në QP Prishtinë dhe hapja e tunelit	Qendra e Paraburgimit Prishtinë
Ndarja e hyrjes për vizitorë dhe staf në QP Prishtinë” – Faza e dytë	Qendra e Paraburgimit Prishtinë
Rrënimi i garazheve të vjetra në Q.P Prizren	Qendra e Paraburgimit Prizren

*1.Projekti “Renovimi i Brendshëm i Portës së re në Q. K. Dubrave” është punuar nga të të burgosurit e Qendrën Korrektuese në Dubravë si dhe disa pozicione nga Kontraktuesi.*



*2. Projekti: Instalimi i ujëmatësve digjital ne sistemin e ujësjellësit ne Q. K. Dubravë*

**Janar 2021**

---





*3. Renovimi i kuzhinës në QK Smrekovnicë – Renovimi është realizuar nga puna me të burgosur si dhe disa pozicione nga kontraktuesi. Sipërfaqja e kuzhinës me të gjitha hapësirat ndihmëse është 1,450m<sup>2</sup>.*




**Janar 2021**

---





*4. Renovimi i brendshëm i kuzhinës në objektin e administratës në Q.K.Dubravë, pjesa demoluese dhe pjesa më e madhe e punimeve është bërë nga të burgosurit e Qendrës, ndërsa furnizimi me material dhe një pjesë e punimeve nga Operatori Ekonomik. Objekti i kuzhinës së renovuar përmban hapësirat për ngrënie, hapësirat për përgatitjen e ushqimit, përgatitjen e mishit, sallatës, marrjen e ushqimit, hapësirën për larjen e enëve.*





**5. Ndarja e hyrjës për vizitor në QP.Gjilan ,realizuar nga Operatori Ekonomik “Progis”-Gjilan me vlerë të kontratës 58,492.60€.**

*Në këtë projekt është paraparë ndërtimi i anexit që do të shërbejë për hyrje dhe pritje të vizitorëve për të burgosurit e kësaj Qendre si dhe renovimi i hyrjës ekzistuese. -realizuar nga puna e të burgosurve.*



**6.Projekti: Ndarja e hyrjës për vizitorë dhe stafin në Q.P.Gjilan-faza II”- realizuar nga Operatori Ekonomik “OSMANI HOLDING”-Lipjan , me vlerë të kontratës 8,985.00 €.**

*Në këtë projekt është paraparë streha në hyrje të objektit,si vazhdimësi e strehës ekzistuese.*

**Janar 2021**

---





**7. Projekti- “Rrethimi i shëtitoreve me tel në QP.Prishtinë” .**

*Është bërë zhvendosja e telit rrjetë ekzistues me fusha me dimensione 5x5cm,si dhe montimi i telit rrjetë me fusha 2.5x2.5cm në katër shëtitorët ,si dhe në hapësirat ndarëse në mes të shëtitoreve.*

*Ky projekt është donacion nga ICITAP.*



**8.Projekti -“Rrethimi i shëtitoreve me tel në QP.Gjilan” :**

*Janë betonuar shtyllat metalike në vrimat e hapura paraprakisht .Është bërë zhvendosja e telit rrjetë ekzistues me fusha me dimensione 5x5cm,si dhe montimi i telit rrjetë me fusha 2.5x2.5cm*

**Janar 2021**

*në katër shëtitoret ,në hapësirat ndarëse në mes të shëtitoreve,si dhe në njërin tunel që të dërgon prej pavionit në shëtitore.*

*Ky projekt është donacion nga ICITAP*




**9. Projekti kapital: “Instalimi i bravave- rrezeve të dorës në Burgun e Sigurisë së Lartë” dhe me numër të kontratës: 33600-21-2437-5-2-1/C121**

*Projekti “Instalimi i bravave – rrezeve të dorës në Burgun e Siguris së Lartë” është konceptuar , dizajnuar dhe implementuar nga ana e Zyrës së Inxhinieringut. Projekti është realizuar nga operatori ekonomik E-connect AL SH.P.K*


*Shuma totale e Kontratës për këtë projekt është 17 091.50€.*

*Shuma e pagesës e realizuar për këtë projekt në total 15 784.80€.*



**Para investimit**

**Pas investimit**



Para investimit



Pas investimit




Para investimit



Pas investimit





**Paneli informues për gjendjen e portës (hapur/mbyllur)**

**kanaletat**



**Para investimit**



**Pas investimit**



Kudri me paisjen elektronike të kontrollit të casjes

10. Për kontratën: “Furnizimi me material esencjal elektrik për institucionet korrektuese” dhe me numër të kontratës: 33600-21-1355-1-3-6/C110.

*Kontrata e furnizimit është realizuar nga operatori ekonomik “LIRIA” sh.p.k*

*Shuma totale e Kontratës për këtë furnizim është 9 275.00€.*

*Shuma e pagesës e realizuar për këtë furnizim në total 9 275.00€*

11. Për kontratën: “Furnizimi me material esencjal elektrik për SHKK” dhe me numër të kontratës: 33600-21-7516-1-2-1/C142.

*Kontrata e furnizimit është realizuar nga operatori ekonomik “BAK ING” sh.p.k*

*Shuma totale e Kontratës për këtë furnizim është 13 683.31€.*

*Shuma e pagesës e realizuar për këtë furnizim në total 13 683.31€*


12. Projekti kapital “Ndarja e hyrjes për vizitorë dhe staf në QP Prishtinë dhe hapja e tunelit”

*Projekti “Ndarja e hyrjes për vizitorë dhe staf në QP Prishtinë” është konceptuar, dizajnuar dhe implementuar nga ana e Zyrës së Inxhinieringut. Projekti është ndërtuar në anën e majtë të pjesës hyrëse në QP Prishtinë, i përbërë nga objekti jashtë perimetrit të murit 90m<sup>2</sup> - pjesa infrastrukturore e legjitimitetit dhe sigurisë së vizitorëve, si dhe objekti brenda perimetrit të murit 83m<sup>2</sup> - pritja për vizitorë, të cilët objekte ndërlidhen ndërmjet veti përmes murit perimetrik rrethues, me sipërfaqe totale të Përdhësës prej 173m<sup>2</sup>.*

Shuma totale e Kontratës për këtë projekt është 58 558.00€. Realizuesi: “NIL ARCHITECTS”SHPK & “ADEMAJ ARCH -ING”SHPK & “HIDRO PROJECT”SHPK

Planifikuar	Realizuar
<p data-bbox="188 450 694 963"> </p> <p data-bbox="188 1003 416 1037"><i>Baza e Përdhesës</i></p> <p data-bbox="188 1070 766 1444"> </p>	<p data-bbox="790 477 1412 943"> </p> <p data-bbox="790 981 983 1014"><i>Pamje përpara</i></p> <p data-bbox="790 1093 1300 1480"> </p>





13.Projekti kapital “ Ndarja e hyrjes për vizitorë dhe staf në QP Prishtinë” – Faza e dytë

*Projekti “Ndarja e hyrjes për vizitorë dhe staf në QP Prishtinë” - Faza e dytë është realizuar si vazhdimësi e projektit të parë , ku janë parapa disa pozicione që nuk kanë qenë të përfshira në Fazën e parë , siç janë pllakat e dyshemesë , gletimi dhe ngjyrosja e limituar e Objektivit.*

*Shuma totale e Kontratës për këtë projekt është 6 410.00€ . Realizuesi: “NIL ARCHITECTS”SHPK .*





## IV. PJESA KATËR

### SIGURIA

Duke filluar nga përgjegjësia se çdo institucion korrektues ka për detyrë garantimin e sigurisë parësore për persona të privuar nga liria, stafit dhe vizitorëve. Prandaj, Shërbimi Korrektues i Kosovës ka qenë i përkushtuar që institucionet korrektuese të jenë vende të sigurta për jetesë dhe punë për të gjithë popullatën e burgosur, që jetojnë dhe punojnë brenda qendrave, duke siguruar që të mos ushtrohet asnjë lloj dhune ose kërcenim ndaj jetës dhe shëndetit.

Duke pas parasysh kërkesat e rregullave evropiane të burgjeve, neni 51, masat e sigurisë duhet të jenë në minimumin, i cili nevojitet, për të garantuar sigurinë e të paraburgosurve/të dënuarve në institucion. Andaj, Shërbimi Korrektues i Kosovës gjatë vitit është angazhuar për të balancuar aktivitetet risocializuese dhe sigurinë. Në punën tonë të përditshme, në institucione korrektuese dhe pas vlerësimit të rrezikut, masat e sigurisë janë zbatuar përmes punës kontrolluese, verifikuese dhe parandaluese, për të ruajtur rendin dhe kontrollin e sigurisë, duke garantuar një ambient të përshtatshëm për të gjithë në institucione korrektuese.

Shërbimi Korrektues i Kosovës si rezultat i një menaxhimi efikas gjatë vitit, ka arritur që të ofroi siguri në nivel të kënaqshëm për të burgosur dhe stafin në institucione korrektuese .

Shërbimi Korrektues i Kosovës, po ashtu në vazhdimësi ka ndërmarr masa të kontrollit me qëllim të parandalimit, zvogëlimin dhe eliminimin e të gjitha dukurive negative si: lëndëve narkotike, telefonave, incidenteve tjera, kontrabandën dhe elementet e tjera të ndaluara në institucione korrektuese.

Me gjithë angazhimin e institucioneve korrektuese dhe ndërmarrja e masave të kontrollit të sigurisë për të parandaluar futjen e gjërave të ndaluara, edhe këtë vit ka pasur përpjekje për futjen gjërave të ndaluara në mënyra të ndryshme në disa institucione korrektuese.

Në këtë drejtim është zhvilluar një progres edhe sa i përket koordinimit, sidomos me gjetjen dhe konfiskimin e kontrabandës, identifikimin dhe kapjen në tentim për të futur kontrabandë, duke e parandaluar atë, si dhe identifikimin dhe lëvizjen e të burgosurve të identifikuar si potencial për trazira apo prishje të rendit në institucione korrektuese.

### 5. Monitorimi i dukurive specifike /radikalizmit në burgje

Në vitet e fundit ka një rritje të shqetësimeve rreth radikalizmit të dhunshëm dhe sulmeve terroriste nga luftëtarët e huaj, e që ka përmasa globale.

Shërbimi Korrektues i Kosovës, ka adresuar me kohë këtë dukuri dhe ka ndërmarr aktivitete të rregullta monitoruese për të identifikuar dhe parandaluar radikalizmin e të burgosurve në burgje dhe në bashkëpunim me ICITAP me mbështetje të tyre profesionale dhe teknike me pajisje, trajnime këshilluese po arrin të monitoroi dhe trajtoi në mënyrë specifike radikalizmin në burgje.

## Monitorimi:

- Me qëllim të monitorimit dhe trajtimit të radikalizmit në institucione korrektuese, kemi arritur të krijojmë një grup formal ndër-institucional dhe multidisiplinar nga institucionet e ndryshme të sigurisë, jo vetëm për vlerësimin e të dënuarve të radikalizuar, por edhe për shkëmbimin e informatave të ndryshme.
- Janë implementuar dhe vazhdojnë të zhvillohen edhe më tutje programet specifike (individuale dhe grupore) në burgje për trajtimin e të burgosurve të kësaj kategorie.

Për adresimin dhe trajtimin e radikalizmit në burgje, Shërbimi Korrektues i Kosovës është pjesë e aktiviteteve të Këshillit të Evropës përmes pjesëmarrjes në grupet punuese, si dhe është përfituese nga Projekti i Këshillit të Evropës përmes/Instrumentit Horizontal II për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019/2022, me temën “Përmirësimi i kapaciteteve ndëshkuese në adresimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në burgjet e Ballkanit Perëndimor”.

Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën, Shërbimi Korrektues i Kosovës është vlerësuar një “Shembull i praktikës së mirë në rajon” në adresimin, trajtimin dhe monitorimin e radikalizmit në burgje.

## 6. Njësitë për Përcjelljen e të Burgosurve

Ka vazhduar punën e suksesshme edhe gjatë vitit 2021 duke performuar një profesionalizëm të lartë në përfaqësimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës përmes përcjelljes së sigurt të të burgosurve sipas kërkesave anekënd institucioneve të drejtësisë të Republikës së Kosovës.

*Tabela nr.2 Përcjelljet e të burgosurve gjatë vitit 2021.*

Të burgosur	Gjykatë	Prokurori	Spitale	Transfere	Kategori RRL	Kategori RRSHELL	Punë në IK	Shkollim Jashtë IK	TOTALI
Janar	280	92	176	85	21	4	0	0	658
Shkurt	404	124	171	100	25	6	0	0	830
Mars	454	145	221	187	40	12	0	0	1059
Prill	448	177	170	126	11	5	0	0	937
Maj	352	113	201	109	6	6	65	0	852
Qershor	409	197	285	132	15	5	14	0	1057
Korrik	420	181	354	114	19	8	4	0	1100
Gusht	282	158	341	83	5	11	10	0	890
Shtator	516	158	235	87	13	9	0	0	1018
Tetor	416	134	231	92	9	11	0	2	895
Nentor	481	146	303	113	15	16	0	0	1074
Dhjetor	546	165	312	129	15	12	0	1	1180
<b>Totali</b>	<b>5008</b>	<b>1790</b>	<b>3000</b>	<b>1357</b>	<b>194</b>	<b>105</b>	<b>93</b>	<b>3</b>	<b>5008</b>

**Janar 2021**



Në përcjellje për arsye humanitare gjatë Vitit 2021 janë dërguar **169** të burgosur.

*Tabela nr.3 Përcjelljet humanitare ne vitin 2021.*

QK Dubravë	BSL	QK Smrekonicë	QK Lipjan	QP Mitrovicë	QP Prishtinë	QP Prizren	QP Gjilan	QP Pejë	QKF Lipjan
48	15	15	45	01	14	05	10	04	12

## V. PJESA E PESTË

### ÇËSHTJET LIGJORE

Në bazë të Planit të Punës së Drejtoratit Ligjor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Planit të Punës së Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2021, janë ndërmarr veprime me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe kryerjes së detyrave me përgjegjësi, dhe ka arritur që të jap mbështetjen e nevojshme ligjore për funksionimin efikas të SHKK-së, duke i prezantuar të arriturat tjera vijuese:

#### 7.1 Hartimi i projektligjeve dhe rregulloreve:

-Projektligji për Shërbimin Korrektues të Kosovës – janë shqyrtuar komentet e pranuar nga faza e konsultimeve me publikun, është fazë e finalizimit;

-Projektligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale - janë shqyrtuar komentet e pranuar nga faza e konsultimeve me publikun, është fazë e finalizimit;

-Projekt Rregullorja për Organizmin e Brendshëm të SHKK-së - është hartuar drafti fillestar.

#### 7.2 Vizita në institucionet korrektuese lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit:

Gjatë vitit janë realizuar vizita në gjitha institucionet korrektuese lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit dhe janë përcjellë raportet me të gjeturat dhe rekomandimet.

#### 7.3 Rregulla të brendshme të miratuara

-Planin e shfrytëzimit të pushimit jashtë institucionit korrektues për të dënuar.

#### 7.4 Kërkesat për faljen e dënimit:

- Gjatë vitit 2021 kanë bërë kërkesa për falje të dënimit 105 (njëqind e pesë) të dënuar.



## 7.6 Kërkesa për pezullim të ekzekutimit të dënimit

Gjatë vitit 2021 kemi pasur 8 (tetë) kërkesa për pezullim dënimit për arsye të gjendjes jo të mirë shëndetësore.

-3(tre) kërkesa të refuzuar, 2 (dy) të dënuar ka vdekur gjatë procedurës së pezullimit dhe 1(një) është pezulluar dhe pas skadimit të pezullimit është kthyer në mbajtje të dënimit.

## 7.7 Ekstradim dhe Transferim:

Gjatë vitit 2021 në zyrën ligjore kemi pranuar dhe kemi përcjellë përgjigje për transferim dhe kërkesa me njoftimin për ecurinë e ekzekutimit të dënimit me burg të personave të transferuar në Kosovës për të mbajtur pjesën e mbetur të dënimit nga Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë kemi proceduar këto kërkesa:

-1(një) kërkesë të përcjellë nga Ambasada e Kuvajtit në Shqipëri për informacione rreth procedurave në Republikën e Kosovës sa i përket vizitave të misioneve diplomatike tek të dënuarit që janë shtetas të tyre;

-1(një) kërkesë nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë për transferim të burgosurit brenda institucione korrektuese të Republikës së Kosovës;

-3 (tre) kërkesa për informacione shtesë lidhur me ekstradimin e të burgosurve në Republikën e Kosovës e të cilat ndërlidhen me Shërbimin Korrektues të Kosovës;

-5 (pesë)kërkesa se a ka kapacitete Shërbimi Korrektues i Kosovës për të pranuar të burgosurit e ekstraduar-transferuar në institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës;

-2 (dy)Njoftim për të ekstraduarit nga Gjermania për në Republikën e Kosovës për të vuajtur dënimin e shqiptuara nga gjykatat themelore, për llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim në shtetin e tyre;

-3(tre) Kërkesë për pëlqimin e të dënuarit për transferimin e tij në institucionet korrektuese të shtetit të origjinës;

-1(një) kërkesë për informata mbi natyrën e kohëzgjatjes së dënimit lidhur me transferimin e të burgosurit nga institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës në institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës;

-1(një) kërkesë nga ambasada Belge në Prishtinë për më shumë informacione për shtetasin e tyre i cili gjendet në vuajtjet të dënimit në Qendrën Korrektuese Dubravë;

-1 (një)njoftim për të dënuarin e arratisur me të dhënat se sa ka qëndruar në vuajtje të dënimit dhe i është përcjellë kryetarit të gjykatës themelore.

-1 (një) kërkesë nga ambasada e Francës në Prishtinë, për lejimin për ta vizituar të dënuarën , për veprën penale të kryer në Francë ku e ka pas vendbanimin e përhershëm;

-1 (një) referim kërkesës të pranuar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Austrisë nëse i dënuari ka përfunduar mbajtjen e dënimit marrë përsipër nga autoritetet kosovare, pas transferimit të tij nga institucionet korrektuese të Austrisë;

-1 (një) kërkesë për informacione nga Ambasada e Austrisë;

-2 (dy) Deklarata nga Drejtori i SHKK-së pas kërkesës së Ambasadave se institucionet korrektuese i përmbushin kushtet dhe standardet sipas konventës Evropiane për të drejtat e Njeriut datës 4 nëntor 1950 dhe standardet minimale sipas Rregllave Evropiane të Burgjeve të datë 11 janar 2006.

### **7.8 Zbatimi i politikave strategjike shtetërore.**

Mekanizmat ndërministrorë, Shërbimi Korrektues i Kosovës është një ndër akterët e hartimit dhe implementimit të dokumenteve strategjike shtetërore dhe përfaqësues profesionist nga Shërbimi Korrektues i Kosovës kanë marr pjesë në hartimin dhe implementimin e tyre duke përmbushur obligimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës në përfaqësimin në mekanizma ndërministrorë dhe raportimin periodik tremujor tek Koordinatori Nacional në Ministrinë e Punëve të Brendshme për implementimin e dokumenteve strategjike në vijim:

- Strategjia shtetërore për Parandalimin e Ekstremizmit dhe Radikalizmit të Dhunshëm që Shpie në Terrorizëm 2015-2020 dhe Planit të Veprimit;
- Strategjia shtetërore kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit, 2018-2022;
- Strategjia shtetërore kundër Krimit të Organizuar dhe Plani i Veprimit, 2018-2022;
- Strategjia shtetërore kundër Narkotikeve dhe Plani i Veprimit, 2018-2022.

Për më tej, Shërbimi Korrektues i Kosovës në vazhdimësi ka kontribuar në përmbushjen obligimeve dhe përgjegjësisë të saj, duke ndihmuar në arritjen e objektivave dhe synimeve të politikave strategjike shtetërore për fushat e luftimit të dukurive negative në kuadër të institucioneve korrektuese.

## VI. PJESA E GJASHTË

### BURIMET NJERËZORE

Gjatë vitit 2021, Njësia e Burimeve Njerëzore në kuadër të kompetencave ligjore, ka organizuar punën dhe aktivitetet me qëllim të arritjes së objektivave të përgjithshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Numri i përgjithshëm i nëpunësve në fillim të vitit 2021 ishte 1628, prej të cilëve 1421 të gjinisë mashkullore dhe 207 të gjinisë femërore.

Është hapur konkursi për regrutimin e pesëdhjet zyrtarëve korrektues, procedura tani është në fazën e vlersimit të kandidatve.

Sistemi elektronik për menaxhimin e burimeve njerëzore është azhuruar me të dhënat nga dosja personale e secilit zyrtar.

Janë përgatitur dhe ofruar vërtetime të dëshmisë së punësimit sipas kërkesave të zyrtarëve. Në baza të rregullta është evidencuar vijueshmëria e stafit si dhe është bërë përditësimi i evidencës së pushimeve vjetore dhe mjekësore;

*Tabela nr.4 Struktura gjinore e nëpunësve në fund të vitit*

Gjinia			
Niveli i Institucionit	Meshkuj	Femra	Totali
Gjithsej	1385	202	1587

*Tabela nr.5 Nacionaliteti*

Nacionaliteti	Numri i të punësuarve
Komunitetet	
Shqiptarë	1,447
Serbë	98
Boshnjakë	26
Turq	3
Rom	9

**Janar 2021**



Kroatë	1
Malazezë	3

1,587

Tabela nr.6 Largimet e stafit nga puna sipas kategorive

Largimet	Me dëshirë (dorheqje)	Masë disiplinore	Pensionim i parakohshëm	Pensioni m i rregullt	Vdekje
Niveli i Lartë Drejtues	0	1	0	0	0
Niveli Drejtues	0	3- shkarkim	0	4	1
Niveli Profesional	9	4	0	11	2
Niveli Teknik-Administrativ	2	1	0	03	0
Gjithsej	11	9	0	18	3

### 9. Masat disiplinore ndaj personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Në vitin 2021 janë iniciuar 58 raste të procedurës disiplinore, komisioni disiplinore ka shpëtur keto masa:

06 raste, largim nga shërbimi civil;

03 raste të shkarkimit me vendim të ministrit

09 raste, ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës

09 -raste është vendosur masa disiplinore ndalim në të ardhura;

22 rastet kanë përfunduar me vërejtje;

05 raste janë liruar nga përgjegjësia;

04 raste është pezulluar procedura deri në vendosjen nga gjykata.

### 10.Kërkesat dhe ankesat e personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës

Ankesat

Janar 2021

Komisioni i Ankesave ka pranuar tetembdhjet ankesa, per te gjitha ankesat ka vendosur me vendim.

#### Përgjegjeje ne padi

Gjate vitit 2021 permes avokatures se shtetit kemi pranuar 150 kerkesa per pergjegjeje ne padi kryesisht për page jubilarë sipas marrveshjes se pergjithshme kolektive e cila ka qene ne fuqi nga 01.01.2015 deri me 31.12.2017, ne te gjitha rastet jemi pergjigjur ne padi duke i percjellur edhe dokumentacionin e nevojshem.

### 11. Zhvillimi Profesional i Stafit

Gjatë vitit 2021 për stafin e Shërbimit Korrektues të Kosovës janë organizuar trajnime profesionale për ngritjen të shkathtësive për fusha të nevojshme për ushtrimin efikas të detyrave të punes, trajnimet janë organizuar dhe mbajtur nga Akademia e Kosoves per Siguri Publike dhe Instituti i Kosoves per Administrat Publike.

Në vitin 2021 është mbajtur punëtorja tri ditore e mbështetur nga ICTAP për hartimin e dokumentit strategjik te trajnimeve per personelin e shërbimit korrektues, pjesëmarrës ne ishin një delegacion nga Shoqata Ndërkombëtare e Korrektiveve dhe Burgjeve (ICPA).

*Tabela nr.7 Trajnimet gjatë vitit 2021*

Nr	Trajnimi	Numri i trajnimeve	Numri i Pjesëmarrësve
1	Trajnimi një ditor për plane operativ	04	67
2	Trajnimi themelor për armë automatike MP-5	05	71
3	Trajnimi Vlerësimi i Rrezikut dhe Nevojave për Recidivizëm	02	20
4	Trajnim Menaxhimi më të burgosurit më çrregullime psiqik	03	45
5	Seminari një ditor i kursit HELP për Parandalimin e Radikalizmit	01	15
6	Trajnimi themelor për armë te shkurta Glock 19	05	56

**Janar 2021**

7	Kursi Menaxhimi i vijës së parë	01	11
8	Trajnimi Menaxhimi i Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë	01	12
9	Ricertifikimi me armë MP-5	26	339
10	Sjellja me njerëz dhe detyrat në vendin e punës	02	30
11	Trajnimi i Njësia e Nderit	01	18
12	Trajnimi Krimet e urrejtjes	01	12
13	Ricertifikimi me armë Glock 19	49	674
14	Intervistimi Motivues	2	33
15	Trajnimin mbi të drejtat e njeriut në burgje OSCE	1	28
16	Trajnimi për kapje dhe kontroll, Njësiti Intervenues	05	78
17	Trajnimin Programi për aftësimin e Instrukturëve (PAI)	01	04
18	Trajnimi Sistemet e Reagimit në Emergjencave OSCE	01	10
19	Menaxhimi elektronik i kontratave	02	30
20	Menaxhimi i stresit	5	40
21	Shkathësit e Komunikimit	2	20
22	Motivimi i stafit	2	4
23	Trajnim mbi komunikimin strategjik dhe rëndësinë e tij për institucionet e sigurisë	1	1
	Totali	123	1618



## VII. PJESA E SHTATË

### PILOT PROJEKTET PËR THEMELIMIN DHE FUNKSIONALIZIMIN E MEKANIZMAVE

#### Qëllimi i Projektit të Njësisë së Inteligjencës

Themelimi i Njësisë së Inteligjencës ka për qëllim që menaxhmenti të jetë mirë i informuar rreth sigurisë në burgje, parandalimin dhe luftimin e dukurive negative- kontrabanda, korrupsioni, llojet e kërcënimeve dhe sulmeve të mundshme brenda dhe jashtë institucioneve.

Lidhur me këtë projekt, Shërbimi Korrektues i Kosovës vazhdon të mbështetet nga Departamenti i Drejtësisë së SHBA-ve, Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnime në Hetimet Penale (ICITAP).

• ICITAP është duke e mbështetur Shërbimin Korrektues të Kosovës nga viti 2016 dhe ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021.

*Tabela nr.8 Totali i raporteve*

Totali i raporteve			
Raportet e Përgjithshme	Në Pritje	Raportet Pozitive	Totali
Totali	267	75	342

#### Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve

Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim Burgosurve, duke u bazuar në praktikat bashkëkohore ka bërë vlerësimin e rrezikut dhe nevojave, si dhe planifikimin e dënimit, për të dënuarit me qëllim që t'u ofrohet trajtim adekuat gjatë mbajtjes së dënimit përmes programeve adekuate që i përshtatën nevojave individuale të dënuarve, për të arritur risocializimi dhe riintegrimi i dënuarve në shoqëri, e gjithësi edhe ulja dhe zvogëlimi recidivizmit.

## VIII. PJESA E TETË

### TRAJTIMI/ RISOCIALIZIMI DHE PËRGATITJA PËR RIINTEGRIM

Shërbimi Korrektues i Kosovës është i përkushtuar në përmbushjen e rolit të vet për të ndihmuar të burgosurit për t'u reformuar dhe për t'u bërë qytetarë më të mirë dhe produktivë për veten e tyre, familjet dhe komunitetin.

Shërbimi Korrektues i Kosovës ka krijuar kushte dhe ka ofruar mundësi të burgosurve për realizimin e të drejtave fundamentale në të gjitha institucionet korrektuese, siç janë:

E drejta në parashtrës;

Korrespondencën e pakufizuar;

Ndihmën juridike sipas kërkesave të tyre;

Vizitat;

Ruajtja e pronës personale të tyre në burg;

Aftësimin profesional;

Arsimimin;

Informimin;

Aktivitetet kulturore rekreative dhe sportive;

Ushtrimi i të drejtës së fesë;

Ankimet dhe kërkesat;

Pushimi për raste të jashtëzakonshme;

Puna dhe punësimi brenda dhe jashtë institucionit;

Transferimet sipas kërkesave të burgosurve në institucione korrektuese si dhe

Një numër të konsiderueshëm të beneficioneve siç janë:

Pushimi në shtëpi;

Kalimi kohës në lokale të veçanta me bashkëshortin/en;

Vizita te organizuara për të mitur jashtë institucionit edukativo korrektues, etj.

## **IX. PJESA E NËNTË**

### **INSTITUCIONET KORREKTUESE**

Institucionet korrektuese mbeten të përkushtuar që të luaj rolin e tyre, për ti ndihmuar të burgosurit që të ndryshojnë pozitivisht dhe të përgatiten për riintegrim në shoqëri, si individ të përgjegjshëm dhe të dobishëm për shoqërinë dhe rrethin ku do të jetojnë.

Sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe akteve nënligjore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, institucionet korrektuese kujdesen për ofrimin e kushteve për të burgosurit që t'i realizojnë të drejtat e tyre për mes zhvillimit të programeve, aktiviteteve rutinore ditore brenda institucionit korrektues. Në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës janë 11 institucione korrektuese në të cilat janë zhvilluar aktivitete të ndryshme.

Aktivitete të rëndësishme janë zhvilluar në të gjitha institucionet korrektuese dhe jashtë tyre, ato janë si në vijim:

#### **12. Arsimimi i të burgosurve**

Personi i dënuar ka të drejtë në shkollim fillor dhe të mesëm në pajtim me ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm.

Të burgosurve iu ka ofruar arsimim sipas programeve ekuivalente të Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë.

Duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Drejtësisë – Shërbimit Korrektues të Kosovës, institucionet korrektuese janë përkujdesur:

- Për sigurimin e hapësirave mësimore, mirëmbajtjes dhe riparimit të tyre;
- Sigurimin e materialeve shpenzuese;
- Sigurimin e ambientit të shëndetshëm për organizimin e procesit mësimor;
- Zbatimi i udhëzimit administrativ për organizimin dhe planifikimin e procesit arsimor në arsimin para universitar në institucionet korrektuese për personat e privuar nga liria;
- Planifikimi dhe organizimi i procesit mësimor në institucionet korrektuese;
- Organizimi i kurseve për aftësim profesional;
- Evidentimi i nxënësve që do të vijojnë shkollimin në vitin kalendarik 2021/2022.



### 13. Regjistrimi i nxënësve sipas paraleleve të ndara të shkollave amë për vitin shkollor

**Në Qendrën Korrektuese në Lipjan numri i të miturve që kanë vijuar mësimin ka qenë.**

Në shkollën në Qendren Korrektuese për të Mitur në Lipjan, e cila funksionon si paralele e ndarë e dy shkollave amë në Lipjan (SHMP "Adem Gllavica" dhe SHFMU "Ismail Luma"), numri i të miturve të cilët momentalisht ndjekin mësimet është 24 (20 QKML dhe 04 QEKL) prej tyre 08 vijojnë mësimet në shkollën e mesme të ulët (nga kl 6 deri 9 dhe 16 ndjekin mësimet në shkollën e e mesme të lartë (nga kl 10 deri 12), poashtu studimet universitare kanë vijuar 3 të mitur.

#### **Femrat**

- Një e mitur me masë edukative ka vijuar mësimin në Qendrën Korrektuese në Lipjan.
- Një e dënuar ka ndjekur studimet në Kolegjin AAB.

#### **Paralelja e ndarë në Qendrën Korrektuese në Dubravë**

Numri i nxënësve që kanë regjistruar vitin shkollor 21/22 në shkolla e mesme e lartë (X – XII) është 55 nxënës gjysëmvetorin e parë e kanë përfunduar 42 nxënës

Viti shkollor 2021/2022, ka filluar sipas kalendarit shkollor të arsimit (MASHT-it).

Procesi mësimor për të gjitha nivelet është organizua konform rekomandimeve të MASHT-së, si dhe Institutit të Kosovës për Shëndetësi në rrethanat e pandemisë Covid 19.

### 14. Programet trajnuese në institucionet korrektuese

Drejtoria për trajtim të të burgosurve dhe të miturve – sektori për arsim, programe dhe aftësim profesional në bashkëpunim me zyrat për trajtime të burgosurve dhe të miturve në institucionet korrektuese, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës dhe donatorët, ndihmon dhe përkrahë promovimin dhe përfshirjen e të burgosurve në çështjen e aftësimin dhe punësimit.

#### **Numri i pjesëmarrësve në kurset trajnuese në Shërbimin Korrektues të Kosovës**

Qendrën Korrektuese për të mitur Lipjan janë certifikuar 7 të mitur në ndërtimtari, 2 të mitur në Elektrikë dhe 4 të mitur vijojnë aftësimin.

Femrat: Në furtari kanë ndjekur trajnimin 4 të dënuar dhe së shpejti pritet certifikimi nga Qendra e Aftësimi Profesional në Prishtinë, në punëtorinë e rrobaqepësise sfidë kryesore ka qenë prodhimi i maskave për covid 19, ka pasur edhe disa donacione me material për qepje për maska, ku në depo të institucionit janë 1700 copë maska.

Në Qendrën Korrektuese Dubravë: Aftësimi profesional e kanë përfunduar 22 të burgosur në profile: axhustator 7, zduktari 5, hidroinstalim 7, kuzhinier 3.

Aftësimin profesional e kanë ndjekur edhe të miturit si: ndërtimtari 7 janë certifikuar, elektrikë 2 të mitur dhe 4 vijnë aftësimin, hidroinstalim 3 të mitur dhe 3 vijnë aftësimin ndërsa kursin për kompjuter 2 mitur janë certifikuar dhe 2 vijnë .

### 15. Programet rehabilituese

Programet rehabilituese dhe aktivitetet tjera:

*Tabela nr.9 Programi rehabilitues.*

Nr	Programi	Institucioni	Numri i pjesmavesve/te burgosurve	Trajnere t/ realizatoret
1.	”Menaxhimi i Zemërimit“	Q.K.Femra-Lipjan	05 – të burg. femra	Social
		Q.K.Dubrave	10 – të dënuar madhor	Social
		BSL	05 – të dënuar madhor	Social
		Q.P.Prishtinë	18- të dënuar madhor	Social
		Q.P.Gjilan	05 – të dënuar madhor	Social
2.	"Biseda për Ndryshim"	Q.E.K.Lipjan	02 - të mitur	Social
3.	"TOP'S"	Q.K.Lipjan Q.E.K.Lipjan	09 – të mitur 02- te mitur	Social
4.	"Programi Rehabilitues i Përgjithshëm me 10 sesione	BSL	02 – të dënuar madhor	Social Psikolog
5.	„Shkathësitë Konkrete për marrëdhënje pune për të dënuarit“	Smrekonicë Q.K.Femra-Lipjan	06 – të dënuar madhor 05 – të dënuara femra	3-Zyrtar nga NJVKB
6.	Trajnim/Punëtori Programi UPSHIFT (on line) 03.03.2021, 08-12.03.2021	QKLM dhe QEKL	05 - të miturit	OJQ-Ipko



	Të miturit fituan garën ndaj nxënësve nga shkolla tjera dhe u certifikuan me dt.17.03.2021			Fondatio n Mentor: 1- Z.Social
--	--	--	--	--

Në kuadër të programit "Menaxhimi i Zemërimit", në Q.K.Dubravë dhe BSL, kanë qenë të kyqur edhe të burgosur të dënuar për vepra terroriste në mënyrë që të ndihmohet procesi i rehabilitimit dhe ri-integritimit të tyre.

- Stafi social si menaxher rasti, lidhur me plotësimin e nevojave të të burgosurve ka referuar rastet te: Qendra për Punë Sociale (108 raste), Ambasada (12 raste), Kryqi i Kuq Kosovar dhe Ndërkombëtar (7 raste), KMLDNJ-në (8 raste), Qendra të Shëndetit Mendor (2), Avokatin e Popullit, QKRMT, Komunat, dhe organizata tjera për qështje të ndryshme për të burgosurit siç janë: ndihma për veshmbathje, rregullim të dokumenteve personale për të burgosurit, për lidhje kurore, për marrje pensioni, të veteranit si ish pjeshtarë të UÇK-së, marrje shtetësisë së Kosovës, kërkesa për verifikim nga ana e Policisë së Kosovës, vërtetime që janë në mbajtje dënimi, thirrje të zyrtarëve fetar, avokat etj.

## 16. Aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me rehabilitimin e të burgosurve

Në kuadër të institucioneve korrektuese janë edhe bibliotekat (11 sosh), të cilat posedojnë një numër të konsideruar të titujve të dedikuara për lexues (të burgosur).

Gjithherë sipas raporteve numri i lexuesve është i mirë, por nevojat janë edhe për tituj të rij.

Nga prilli i vitit 2017 bibliotekat kryesisht janë pajisur me tituj të rij nga donatorët, si:

- BIK nga të cilët na u dorëzuan një sasi librash, takvima/kalendar për nevojat e institucioneve korrektuese;
  - Kryqin e Kuq Ndërkombëtar e të cilët na dhuruan si donacion 200 tituj libra dhe një sasi mjetesh për zhvillimin e aktiviteteve të sportit në vlerë 3000 euro;
  - Nga autori znj. Kumrije Hoxha dhe z. Ramadan Thaçi 700 tituj të librave mbledhur dhe dorëzuar në SHKK të cilat iu janë ndarë institucioneve korrektuese.
- Kursin "Shkathësi konkrete për mardhënje punë për të dënuara "kanë vijuar dhe janë certifikuar 5 te dënuara .
  - Punëtorja e titulluar "PODIUM", organizuar nga IPKO Foundation dhe Unicef, kanë marrë 4 të dënuara nga QKF në Lipjan dhe kanë fituar projektin me vlerë 500 euro me temën "Dhuna në familje"
  - Ekspozitë me pikturat e punuara nga të dënuarat si dhe është shfaqur një video (animacion) i shkurt me temën e dhunës në familje e mbeshtetur nga EULEX, ku në kuadër të këtij



aktiviteti janë shpërndare 100 copë udhëzues (broshura) në Shkollën e mesme “Ulpiana” në Lipjan të punuara nga grupi i dënuarave ;

- Aktivitet në pikturë dhe skulpturë në kuadër të projektit “Galeria Mobile”, i realizuar nga dy artistë Albulen Neziri, skulptorë dhe Besnik Hasanaj piktorë ku kanë marrë pjesë 06 të mitur (02 të mitur të dënuar dhe 04 të mitur me masë edukative)
- Koncert nga këngëtarja Albulena Ukaj për të burgosurat për festën e Kurban Bajramit;
- Programi rehabilitues TOP-s, në të cilin kanë marrë pjesë 13 të mitur, të cilët janë trajnuar me metodologjinë TOP-s nga 10 trajnerët e certifikuar nga Komiteti Holandez i Helsinkut.
- Është organizuar edhe një turnir i futbollit për të burgosurit e QKD-së ku kanë marrë pjesë 21 ekipe nga gjitha pavijonet, më 200 pjesë (lojtarë) të burgosur dhe dy vendet e para në finale u shpërblyen me kupa.

### 17. Punësimi i të burgosurve në institucione korrektuese

Bazuar në udhëzimin administrativ për punësimin e të burgosurve në institucionet korrektuese, si dhe jashtë institucioneve korrektuese një numër i konsideruar i personave të privuar nga liria janë punësuar në Punëtori (industri) dhe fermat institucionale, të cilat operojnë drejtpërdrejt nga administrata e burgjeve apo edhe tek operatorët privat.

Të burgosurit në Shërbimin Korrektues të Kosovës janë të punësuar, kryesisht në bujqësi, mirëmbajtje të mjedisit, në punëtori, kuzhinë, lavantari, ndërtimtari, sera dhe në mirëmbajtje të infrastrukturës etj.

*Tabela nr. 10 Numri i të burgosurve të cilët kanë punuar Janar- Dhjetor 2021*

nr	Institucioni	Dhjetor 2020	janar 2021	shkurt 2021	mars 2021	prill 2021	maj 2021	qershor 2021	korrik 2021	gusht 2021	shtator 2021	tetor 2021	ntor 2021	Dhjetor 2021	
1	Dubrava	577	259	261	296	261	303	294	304	300	289	280	279	277	3980
2	QP Prizren	18	18	17	21	17	18	21	18	19	15	14	14	15	225
3	QP Gjilan	24	23	25	25	25	24	24	25	27	26	29	28	27	332
4	QP Lipjan	35	42	39	49	39	42	38	45	41	34	39	39	30	512
5	QK Lipjan	30	26	28	28	28	24	28	28	28	22	24	22	20	336
6	QP Peja	5	8	7	10	8	9	8	8	8	9	8	9	8	105
7	QP Mitrovica	20	18	20	19	20	18	18	18	19	18	22	19	18	247
8	QP Prishtina	33	26	29	31	29	24	28	29	30	31	30	27	23	370

**Janar 2021**

9	QK Smrekonica	163	74	83	82	83	90	88	90	80	80	95	99	170	1277
10	BSL	181	90	93	88	90	88	86	85	85	87	90	89	89	1241
	<b>Totali</b>	<b>1086</b>	<b>584</b>	<b>602</b>	<b>649</b>	<b>600</b>	<b>640</b>	<b>633</b>	<b>650</b>	<b>637</b>	<b>611</b>	<b>631</b>	<b>625</b>	<b>677</b>	<b>8625</b>

Trendi i interesimit të punësimit të personave të privuar nga liria në vazhdimësi po shënon rritje sidomos pas nxjerrjes së udhëzimit administrativ për punësimin e të burgosurve jashtë institucioneve korrektuese. Pritjet e punësimit janë akoma më të mëdha, por pandemia ka ndikuar në reduktimin dhe ndalimin e të punësuarve jashtë institucioneve korrektuese.

## IX. PJESA E DHJETË

### NJËSIA EKONOMIKE NË INSTITUCIONE KORREKTUESE

Njësia Ekonomike e SHKK-së veprimtarinë e ka ushtruar përmes sektorëve të: Prodhimtarisë bujqësore dhe sektorëve të punëtorive, të cilat ofrojnë riparime dhe shërbime të nevojshme, si dhe punëtorive që janë të shtrira nëpër institucionet e ndryshme.

Njësia Ekonomike ka angazhuar të burgosurit në punë dhe aktivitete të ndryshme, përmes punëve të Njesisë Ekonomike, e që ka ndikuar në rehabilitimin dhe ri-socializimin e personave të burgosur. Njësia Ekonomike përmes punëve dhe trajnimeve të ndryshme ka për qëllim përgatitjen për jetën post penale të këtyre të dënuarve.

Po ashtu, me anë të punës së organizuar në institucione korrektuese synohet në një ulje të konsiderueshme të shpenzimeve të krijuara në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Përveç kësaj, puna e të burgosurave brenda këtyre qendrave normalizon edhe jetën e përditshme të të burgosurve.

Njësia Ekonomike e Shërbimit Korrektues të Kosovës gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2020 edhe pse është përballur me vështirësi të ndryshme si gjithë sektorët tjerë ka arritur të realizoj objektivat e parashtruar dhe ka ndërmarr aktivitete për funksionalizimin e saj, si dhe rritjen e prodhimit të produkteve bujqësore për nevojat e brendshme të burgjeve të Kosovës.

Me punën që është bërë në punëtoritë e institucioneve korrektuese janë furnizuar institucionet korrektuese me një sasi të konsiderueshme të produkteve të prodhuara.

Njësia Ekonomike ka arritur të bëjë shpërndarjen e kulturave të ndryshme, të cilat i ka kultivuar përmes të mbjellave të ndryshme të kulturave bujqësore në 3 (tri) Qendrat e saj: Qendra Korrektuese Dubravë, Qendra Korrektuese Lipjan, Qendra Korrektuese Smrekomicë.

Në vazhdim të punëve vjetore është bërë korrja e grurit, vjelja e qepëve, vjelja e patateve, nivelizimi i ngastrës afër stallës.

Janë furnizuar kuzhinat në nivel të SHKK-së me perime dhe mish. Punë të tjera të cilat janë pothuajse të përditëshme si: lëshimi i gjedheve në kullosa, pastrami i stallave, largimi i plehut organik, largimi plehut likuid, saldime dhe riparime të pajisjeve plotësuese të mekanizimit përcjellës të traktorëve sipas nevojës dhe kërkesave.

*Tabela nr. 11 Statistikat dhe kalkulimet e shpenzimeve dhe të kursimeve - Njësia Ekonomike.*

Prodhimet Vetanake nga Njësia Ekonomike për vitin 2021					
Nr.	Artikujt	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1.	Speca	kg	600	0.80	480.00 €
2.	Domate	kg	200	0.48	96.00 €
3.	Tranguj	kg	1600	0.40	640.00 €
4.	Lakër	kg	3285	0.30	985.50 €

**Janar 2021**



5.	Qepë	kg	4300	0.35	1505.00 €
6.	Patate	kg	7500	0.20	1500.00 €
7.	Molla	kg	1500	0.30	450.00 €
Vlera në total nga prodhimtari vetanake e Nj.E.të Q.K.Smrekonicë					5656.50 €

Tabela nr.12 Prodhimtaria nga QKF Lipjan

Emertimi	Sassia	Njesia	çmimi	
Patate	Kg	443.1	0.5	221.55
Tranguj	Kg	645.5	0.60	387.3
Speca të gjat	Kg	1021.4	1	1021.4
Domate	Kg	762.5	0.8	610
Shalqin	Kg	160	0.3	48
Pjepër	Kg	50	0.5	25
Domate të gjelbërta	Kg	173	1	173
			<b>Totali;</b>	<b>2486.25</b>

- Në Qendrën Korrektuese për femra në Lipjan janë mbjell në afatin optimal 0.63 ha grurë. Investim: Ngritja e pemishtes me 1000 fidane molle në vlerë prej 5,670.60€.
- Janë prodhuar 13,880.00 € bukë 400 gr.në furrën e këtij institucioni nga Shtatori 2021 deri më 31.12.2021 në vlerë prej  $(13,880.00 \times 0.30=)$  4,164.00 €
- Prodhimi i maskave me material anti bakterial:  $21,450.00+600=22,050.00$  copë.Q.K.M dhe femra :Vlera e rezervave të motokultivatorit dhe kositseve 5,460.€ Vlera financiare :  $22,050.00 \text{ copë} \times 0.80) = 17,640.00 \text{ €}$

### Pasqyrimi i Rezervave më 31.12.2021

- 1.Q.P. Prishtinë: Rezervat e 3 kositseve të barit: 455.00€  
 2.Q.P. Gjilan: Rezervat e 3 kositseve të barit: 2,160.00€  
 3.QEK Lipjan :Rezervat e kositseve të barit: 260.00€  
 4.Q.P. Mitrovicë Rezervat e kositseve të barit: 260.00€  
 Gjithsej 1-4 vlera financiare e paisjeve më 31.12.2021 është: 3,135.00€

Vlera e gjithëmbarshme e prodhimitarisë të Njesisë Ekonomike të SHKK-së më 31.12.2021 arrinë vlerën financiare në: 239,806.27 €

Sipërfaqet e përgjithshme të mbjella me grurë në Njësinë ekonomike të SHKK-së në Vitin 2021 janë: 15 ha e 10 ari.

**Investimet kapitale në Njësinë ekonomike gjatë vitit 2021 janë si vijim:**

- Ngritja e pemishteve në Q.K. Dubravë 1000 fidanë mole(6,718.20€) dhe në Q.P. F. Lipjan 1000 fidane molle (5,670.60€)me vlerë financiare gjithsej prej: 12,388.80 €
- Furnizim me pajisje për Njësinë ekonomike në vlerë financiare prej: 33,080,00€
- Furnizimi dhe montimi i 2 Frigo dhomave për ruajtjen e pemëve dhe perimeve 9,760.00€ (4,880,00€+4,880.00€), një në Q.L. Dubravë dhe një në Q.K. Smrekonicë) Investim kapital  
Gjithsej 1-3 = 55,228.00€

**Furnizime- shërbime tjera që kanë të bëjnë me material për prodhimtari:**

- Furnizim emergjent për mbjellje të grurit: 9,371.00€
- Furnizim me artikuj anti covid-19 dhe material për prodhimin e maskave në vlerë financiare prej;5,950.02 €
- Korrje fshirja e 20 ha të grurit në Q,K, Dubravë 2,992.50€
- Ujitja e tokës , 3.5 ha në Q.K. Smrekonicë 385.00€

Gjithsej 1-4 = 18,698.5

*Tabela nr.13 Pasqyra përmbledhëse e të hyrave, shpenzimeve operative, investimeve dhe rezervave datë: 31.12.2021*

Nr	Institucionet e SHKK-së	Vlera e prodhimtarisë në €	Shpenzimet operative në €	Vlera e investimeve në €	Vlera e rezervave në €
1	Q.K. Dubravë	221,589.95	42,047.23	28,138.20	111,482.50
2	Q.K. Smrekonicë	5,656.50	5,237.00	4,880.00	1,027.90
3	BSL	55,793.50	18,157.50	7,360.00	8,837.00
4	QKM Lipjan	1,544.60	1,681.00	1,048.00	1,048.00
5	QKF Lipjan	24,290.25	1,945.80	11,129.80	1,416.00
	<b>Gjithsej:</b>	<b>308,874.80</b>	<b>69,068.53</b>	<b>52,556.00</b>	<b>123,811.40</b>

*Puna e të dënuarave femra Lipjan paraqitur përmes fotove( prodhimi i maskave gjatë pandemisë).*



*Prodhimi i ushqimit per kafshët në Dubravë*





*Mbjellja e 3000 fidanëve të mollës në Q.K. Dubravë*



Ferma në Dubravë





*Ruajtja e Patateve Dubravë*



*Në Burgun e Sigurisë së Lartë ka filluar prodhimi i letrës higjienike për nevojat e institucioneve korrektuese.*

## IX. PJESA E NJËMBËDHJETË

### PROKURIMI

Zyra e Prokurimit në kuadër të përgjegjësiive të saj në harmoni me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës, dhe legjislacionit dytësor të nxjerr nga KRPP-ja është angazhuar që ta realizoj planin e prokurimit për vitin 2021, për ato aktivitete që kanë rrjedhë nga kërkesat e njësiive kërkuese.

Divizioni i Prokurimit gjatë këtij viti raportues ka arritur ti procedoj kërkesat që kanë ardhur nga njësit kërkuese me aprovimin e zyrtarit kryesor administrativ.

Në planin e prokurimit janë të parapara gjithsej:

- 32 aktivitete për tu zhvilluar. Deri në fund të vitit 2021 janë zhvilluar 28 aktivitete të parapara në plan të prokurimit. Të pa proceduara janë edhe 4 aktivitete.
- 16 aktivitete të parapara në planin e prokurimit për furnizime, janë proceduar gjithsej: 15 aktivitete. E pa proceduara është vetëm një aktivitet.
- 12 aktivitete të parapara në planin e prokurimit për Shërbime. Janë proceduar gjithsej: 6 aktivitete. Të pa proceduara janë 6 aktivitete.
- 8 aktivitete të parapara në planin e prokurimit për Punë. Deri me tani janë proceduar gjithsej: 8 aktivitete.
- Procedura të zhvilluara jashtë planit të prokurimi janë 13. Bazuar në LPP për këto aktivitete para se te procedohen e kemi informuar Agjencinë Qendrore te Prokurimit (AQP). Janë nënshkruar gjithsej 40 kontrata. Në proces e vlerësimit është 1 aktivitet. Procedura te prokurimit që operatorët kanë parashtruar ankesa ne Organin Shqyrtues te Prokurimit (OSHP) janë 4.



## XII. PJESA DYMBËDHJETË

### TEKNOLOGJIA INFORMATIVE/TI NË SHKK-SË

Teknologjia informative është administruar dhe mirëmbajtur në nivelin e duhur, e që ka ndikuar pozitivisht në efikasitetin e përmbushjes së obligimeve dhe aktiviteteve të SHKK-së gjatë vitit 2021.

*Tabela nr.14.Gjatë periudhës të vitit 2021, punët të cilat janë realizuar sipas përgjegjësive dhe detyrave nga Sektori i TI-së janë prezantuar në vijim:*

Nr	Projektet	Aktiviteti
1	Avancimi dhe menaxhimi Databazes SIMB. Dhe ri-trajnimi i stafit të shkk për përdorim të kësaj databaze.	1.1 Avancimi i databazes dhe menaxhimi i i SIMB në server virtual se bashku edhe me SQL,IIS. 1.2 Ri-trajnimi i stafit në përdorim të SIMB databazes.
2	Përshtatja e data bazës për menaxhimin e veturave për SHKK, donacion nga PSH.	2.1. Formimi i moduleve dhe përshtatja e sistemit të veturave për sistemin e SHKK. 2.2. Trajnimi i stafit baze që e përdore këtë databaze.
3	Zgjerimi i sistemit VOIP për tere SHKK.	3.1. Zgjerimi i VOIP në perimetrin e brendshëm të Institucioneve Korrektuese të SHKK.
4	Zgjerimi i komunikimit virtual SKYPE	4.1. Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve kompjuterike për tere Institucionet Korrektuese të SHKK-se, për komunikim virtual në mes të burgosurve dhe familjarëve të tyre.
5	Zgjerimi i sub-Domenit i SHKK/MD.GOV	5.1. Formimi i shfrytëzuesve të rinj dhe futja e tyre në domen të SHKK/MD-se. 5.2. Ndërlidhja me domen duke rritur sigurinë kibernetike dhe ofrimin e shërbimeve online në kohë reale.
6	Zgjerimi i Rrjetit të internetit në QK-Dubrave	6.1. Zgjerimi është bërë në pavijonin 4, 5. 6.2. Zgjerimi i VOIP po ashtu në këto pavijone.

Janar 2021

7	Siguria Kibernetike	7.1. Asistimi i stafit te ASHI ne aspektin e Sigurisë Kibernetike për pjesën e SHKK-se.  7.2. Vetëdijesimi i stafit te SHKK ne aspektin se si te jemi te mbrojtur nga sulmet eventuale kibernetike ne sistemet qe ata i përdorin.
8	Video Seancat Gjyqësore për te Burgosurit (Donacion nga ICITAP)	8.1. Ndarja e hapësirave dhe e lokacioneve për këtë sistem ne secilën qendër korrektuese.

### 12.1 Mirëmbajtja:

1. Mirëmbajtja e Rrjetit të Internetit në tërë SHKK.
2. Mirëmbajtja e Telefonisë fikse duke përfshirë edhe instalime të reja në tërë SHKK.
3. Mirëmbajtja e të gjithë email-ve Qeveritar për tere Shërbimin Korrektues te Kosovës.
4. Mirëmbajtja e databazës te SHKK-se SIMB(Sistemi i Menaxhimit te Burgosurve).
5. Mirëmbajtja e DB për te burgosurit e radikalizuar (RRD) realizohet nga TI e SHKK-së.
6. Mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve kompjuterike në elektronike e tyre.
7. Mirëmbajtja e domenit të MD/SHKK.
8. Mirembajtja dhe Servisimin e Pajisjeve kompjuterike nga vet stafit i TI të SHKK-së.

### 12.2 Menaxhimi i kontratave:

1. Menaxhimi i Kontratës për printim dhe fotokopjim me Fotokopje.
2. Shërbimet postare nga PTK.
3. Menaxhimi i Databazave SIMB(databaza kryesore) dhe RRD (Rehabilitim dhe ri integrim).
4. Menaxhimi projektit furnizues me pajisje VOIP.

### XIII.PJESA E TREMBËDHJETË

#### MENAXHIMI I PARASË PUBLIKE/BUXHETIT TË SHKK-SË

Shërbimi Korrektues i Kosovës i ka kushtuar vëmendje të posaçme përmirësimit të performancës dhe transparencës, si dhe përgjegjësi të njësisë buxhetore që janë shpenzues të parasë publike-buxhetit të SHKK-së, në mënyrë që shpenzimi dhe përmbushja e kërkesave të bëhet në pajtim me Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048, Ligjin mbi ndarjet buxhetore nr 07/L-041 dhe Rregullorët në fuqi për Vitin 2021.

*Tabela nr.15 Statistikat e Financave për vitin 2021.*

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Aktual	Shpenzimet Janar -Dhjetor	Mjetet e pa shpenzuara	% krahasuar me buxhetin Fillestar	% krahasuar me buxhetin Aktual
Pagat dhe Shtesat	11,037,184.00	10,855,799.95	10,855,799.95	181,384.05	98.36	100.00
Mallrat dhe Shërbimet	3,878,923.00	3,878,922.82	3,768,577.88	110,345.12	97.16	97.16
Shpenzimet Komunale	962,169.00	962,169.00	962,103.02	65.98	99.99	99.99
Projektet Kapitale	741,000.00	739,425.37	649,134.89	91,865.11	87.60	87.79
<b>Gjithsej</b>	<b>16,619,276.00</b>	<b>16,436,317.14</b>	<b>16,235,615.74</b>	<b>383,660.26</b>	<b>97.69</b>	<b>98.78</b>

Shpenzimi i buxhetit për Vitin 2021 është brënda kornizës Ligjore.

- Shpenzimi i buxhetit krahasuar me Buxhetin Fillestar për të gjitha kategoritë ekonomike është 16,235,615.74 € shprehur në përqindje është 97.69 %
- Shpenzimi i buxhetit krahasuar me Buxhetin Aktual për të gjitha kategoritë ekonomike është 16,235,615.74 € shprehur në përqindje është 98.78 %
- Mjetet e pa shpenzuara për të gjitha kategoritë ekonomike janë 383,660.26 € ose shprehur në përqindje janë vetëm 2.31 %

Gjatë Vitit 2021 janë kryer këto aktivitete:

- Planifikimi i politikave buxhetore ne bashkëpunim me Departamentet dhe Zyrat Përkatëse të SHKK-së
- Përgatitja e kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) 2022-2024

**Janar 2021**



Përcjellja e Qarkoreve Buxhetore  
Qarkorja e parë nr. 2022/01  
Qarkorja e dytë nr. 2022/02

- Përgatitja e planit të buxhetit dhe vlerësimet e hershme 2022-2023-2024- Kërkesat buxhetore
- Përgatitja e planit të Rrjedhës së parasë për të gjitha kategoritë ekonomike sipas strukturës ekzistuese të Planit kontabël
- Menaxhimi i buxhetit sipas planifikimit
- Përcjellja e alokimeve, zotimeve, shpenzimeve sipas rrjedhës së parasë
- Monitorimi i të gjitha transaksioneve financiare
- Kontrollimi i gjendjes së shpenzimeve buxhetore duke krahasuar dhe barazuar raportet e brendshme të SHKK-së me raportet e Ministrisë së Financave
- Përcjellja e Rishikimit të buxhetit dhe lëvizjet e buxhetit gjatë Vitit Fiskal.
- Përcjellja e transfereve nga një kategori ekonomike në një kategori tjetër, dhe përcjellja e transfereve mes zërave ekonomik përmes vendimeve të brendshme – Rregullimet e brendshme.
- Përgatitja e raporteve mujore-tre-6 mujore-9 mujore mujore dhe Vjetore për të gjitha kategoritë ekonomike
- Grumbullimi i shënimeve për Pasqyrat Vjetore Financiare 2021
- Bashkëpunimi me ZKF/MD dhe Ministrinë e Financave për të gjitha raportet ligjrisht të kërkuara.
- Kontrollimi i regjistrimit të faturave që arrijnë në SHKK përmes arhives
- Kontrollimi i obligimeve të pa-paguara- të paraqitura sipas Rregullores në fuqi.
- Përcjellja e rregullave të ligjshme Financiare bazuar në LMFPP-Rregulloreve dhe Udhëzimeve Administrative në fuqi dhe Vendimet Qeveritare .
- Mbikëqyrja e dokumentacionit Financiar dhe dosjeve për të gjitha pagesat në baza Ligjore
- Menaxhimi i përgatitjes dhe përpilimit të informatave për cilindo ndryshim ligjor në buxhet-brenda limiteve buxhetore ligjrisht të aprovuara
- Mbikëqyrja e regjistrimit të Pasurisë Financiare dhe Jo Financiare të SHKK-së sipas Rregullorës në Fuqi.
- Përgatitja Prezantimit të pasurisë dhe inventarizimit në Pasqyra Vjetore Financiare 2021.

**Janar 2021**

---

## XIV. PJESA E KATËRMBËDHJETË

### BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI

SHKK-së ka zhvilluar Bashkëpunim të ngushtë me institucionet partnere përmes një bashkërenditje të mirëfilltë të aktiviteteve për realizimin e synimeve dhe objektivave të përbashkëta të sigurisë dhe sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës.

#### 18. Marrëveshjet e bashkëpunimit

Bashkëpunimi donacion ndërmjet Komiteti Ndërkombëtar dhe Shërbimi Korrektues të Republikës të Kosovës.

Bashkëpunimi donacion ndërmjet Zyra për Invalidët e Luftës, Fëmijët e Dëshmorve të UÇK-së, Drejtoria për Mirëqenie Sociale në Komunën e Pejës dhe Shërbimi Korrektues të Republikës të Kosovës.

Marrëveshje për donacion ndërmjet Departamentit Amerikan të shtetit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (Marrësi Shërbimi Korrektues i Kosovës)

Memorandum Bashkëpunimi në mes të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Organizatës Joqeveritare “Qendra RI-JETA” Ferizaj

Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”-Fakulteti Filozofik.

Marrëveshje për donacion ndërmjet Departamentit Amerikan të shtetit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (Marrësi Shërbimi Korrektues i Kosovës mbështetje për reformën e sistemit të drejtësisë).

Memorandum Mirëkuptimi në mes të: Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Help-Hilfe zur Selbsthilfe e.v (në kuadër të projektit “Fuqizimi socio-ekonomik i Ballkanit Përendimor”)

Marrëveshje për donacion ndërmjet Departamentit Amerikan të shtetit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (Marrësi Shërbimi Korrektues i Kosovës mbështetje për reformën e sistemit të drejtësisë).

Marrëveshje për donacion ndërmjet EULEX dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Marrëveshje për donacion ndërmjet EULEX dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës (Qendra Edukuese Korrektuse Lipjan).

Marrëveshje Mirëkuptimi për Donacion në mes të Shërbimit Korrektues të Kosovës/Ministria e Drejtësisë dhe Donatroit Rexhep Rugova.

Memorandum Mirëkuptimi në mes të: Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Help-Hilfe zur Selbsthilfe e.v .

Marrëveshje për donacion ndërmjet Departamentit Amerikan të shtetit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (Marrësi Shërbimi Korrektues i Kosovës mbështetje për reformën e sistemit të drejtësisë).

Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

## **20. Projektet e jashtme për mbështetjen e SHKK-së**

### **20.1 Bashkpunimi i vazhdueshem me ICITAP dhe INL**

Bashkëpunimi me Departamentin Amerikan të Drejtësisë, Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnime në Hetimet Penale (ICITAP) dhe Departamentin e Shteteve të Bashkuara, Byroja e Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit Ndërkombëtar (INL) dhe Byroja e Kundër Terrorizmit (CT).

Ambasada e Amerikës e në veçanti INL dhe ICITAP, SHKK ka marrë donacion 49 copë detektor statik për kontrollin e te gjithë personave gjate hyrje daljeve në Institucione Korrektuese, ky donacion do te na ndihmoje qe te parandalohet futja e dukurive negative në Institucionet Korrektuese, detektorët janë pajisjet te avancuara te cilat do ua lehtësojnë punën stafit për ti parandaluar futjen e mjeteve te rrezikshme në IK.

- Me datën 10.05.2021 janë montuar, programuar 05 copë detektorë në QP Prishtinë, ku dhe janë trajnuar stafi mbi përdorimin e detektorëve.
- Me datën 11.05.2021 janë montuar, programuar 10 copë detektorë në QKL te miturit dhe QKFL femrat, ku dhe janë trajnuar stafi mbi përdorimin e tyre.
- Me datën 12.05.2021 janë montuar, programuar 06 copë detektorë në BSL, ku dhe janë trajnuar stafi mbi përdorimin e detektorëve.
- Me datën 13.05.2021 janë montuar, programuar 02 copë detektorë në QP Mitrovice dhe 02 cope në QK Smrekonicë ku dhe janë trajnuar stafi mbi përdorimin e tyre.
- Me datën 14.05.2021 janë montuar, programuar 05 copë detektorë në QP Gjilan ku dhe janë trajnuar stafi mbi përdorimin e detektorëve.
- Me datën 15.05.2021 janë montuar, programuar 02 copë në QP Prizren ku dhe janë trajnuar stafi mbi përdorimin e detektorëve.



- Me datën 16 /17.05.21 janë montuar, programuar 15 cope detektorë në QK ne Dubravë ku dhe janë trajnuar stafi mbi përdorimin e detektorëve.
- Me datën 17.05.21 janë montuar, programuar 02 copë në QP Peje dhe trajnimin e stafit.

Me datë 25.01.2021 NJPB/SHKK në kuadër të bashkëpunimit me ambasadën e SHBA-së në Prishtinë, saktësisht me Programin ICITAP & INL, ka pranuar donacion tri automjete kombi të tipit Toyota për nevojat e NJPB-së

Me datë 27.05.2021 automjetet kombi Toyota, janë ndarë si në vijim:

- Një automjet Toyota për nevojat e njësisë së NJPB-së në QK Dubravë;
- Një automjet Toyota për nevojat e njësisë së NJPB-së në QK Lipjan;
- Një automjet Toyota për nevojat e njësisë së NJPB-së në QP Pejë.

Me datën 29.09.2021, 3 automjete Xhip Nisan, janë dhen donacion nga Misioni i Eulexit për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Me datën 01.12.2021, 2 automjete kombi Sprinter Mercedes për bartjen e të burgosurve të rrezikshmërisë së lartë, janë dhen donacion nga Shteti Holandez për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Me datën 03.09.2021 SHKK ka marr Donacion nga Ambasada e Amerikës përkatësisht INL-ja një tabelë muri Smart Board MX265-V2 për Qendrën Operative të SHKK-së. SHKK shprehë falënderim për këtë donacion që Ambasada e Amerikës përkatësisht INL-ja e dhurojë për Qendrën Operative .

Me datën 02.11.2021 misioni i Eulexit ka dhurua 198 Motorolla dorës GP380 si dhe programin për Kodimin e tyre, ku kemi fillua me këtë datë me kërkesën e Drejtorit të përgjithshëm të SHKK-së z. Ali Gashi dhe drejtorit për Siguri dhe Operativ të SHKK-s z. Ilir Kelmendi. Ku total kemi arrit me programua 361 motorolla GP 380 dhe 78 Motorolla bazike GM360.Si dhe është planifikua dhe jemi duke punuar që edhe gjat vitit 2022 të programohen edhe për NJPB për vetura zyrtare motorollat bazike GM360.

## 20.2 Bashkëpunimi me Njësinë Korrektuese të EULEX-it

Përveç detyrave të rregullta që NJK i ka kryer sipas mandatit të misionit për SHKK-në në monitorimin, mentorimin dhe këshillimin mbi çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me çështjet korrektuese, NJK e EULEX-it ka mbështetur SHKK-në edhe me aktivitetet e mëposhtme:

- Plani eventual për reagimin ndaj tentativave për vetëvrasje, vetëvrasjeve dhe vdekjeve në burg, i hartuar nga NJK me ndihmën e Njësisë Mjekësore të EULEX-it, u pasua me punëtori në disa institucione të SHKK-së, të cilat u mbështetën me pjesëmarrjen dhe kontributin e stafit të NJK-së.
- NJK ka vazhduar të këshillojë dhe mbështesë pilot projektet për njësitë si në vijim - Njësia e Vlerësimit dhe Klasifikimit të të Burgosurve, Njësia e Inteligjencës dhe Njësia Ekonomike.
- EULEX-i ka përgatitur “Raportin e Veçantë për Ndikimin e COVID-19 në Sundimin e Ligjit në Kosovë”. Raporti identifikon sfidat me të cilat përballlet sistemi i drejtësisë dhe shërbimi korrektues gjatë pandemisë së koronavirusit dhe ofron rekomandime të zbatueshme për sistemin e sundimit të ligjit në Kosovë për t’iu përgjigjur më mirë krizës shëndetësore e cila është akoma duke vazhduar.
- EULEX-i i ka dhuruar SHKK-së pajisje të ndryshme për zyre, orendi, automjete dhe pajisje për radio komunikim.
- EULEX-i ka dhuruar pajisje furre për funksionalizimin e një furre të re të bukës në Qendrën Korrektuese për femra në Lipjan. Projekti është realizuar në bashkëpunim me UNMIK-un.
- NJK ka organizuar dhe ndihmuar një donacion nga Sistemi Holandez i Burgjeve të dy furgonëve për transport të të burgosurve për SHKK.
- NJK ka organizuar seminare mbi “Trajtimin e të burgosurve me sëmundje mendore” në institucione të ndryshme korrektuese për 220 oficerë korrektues dhe punëtorë socialë.
- NJK ka organizuar një seminar treditör me ekspert holandez lidhur me “Sëmundjet mendore dhe varësisë në burgje” për 30 oficerë korrektues.
- NJK ka organizuar punëtori dyditore për rreth për afërsisht 45 punonjëse femra mbi Fuqizimin e Mëtejshëm të stafit femra të SHKK-së rreth “Teknikave të komunikimit/zgjidhjes së problemeve dhe menaxhimit të stresit”.



- NJK ofroi trajnim për NKVB-në mbi dy instrumente që vlerësojnë problemet e përdorimit të alkoolit dhe drogës, Testin e Identifikimit të Çrregullimeve të Përdorimit të Alkoolit (AUDIT) dhe Testin e Identifikimit të Çrregullimeve të Përdorimit të Drogës (DUDIT).
- EULEX-i ka ndihmuar promovimin e SHKK-së duke financuar video mbi: misionin e Shërbimit Korrektues të Kosovës, Njësinë e Transportit të të Burgosurve, trajnimin dhe aftësimin profesional për të miturit në QK dhe QEK Lipjan, aktivitetet rehabilituese në institucionet e SHKK-së, masat parandaluese kundër Covid 19 në SHKK.
- EULEX-i ka financuar/prodhuar filmin e animuar mbi ndërgjegjësimin mbi “Dhunën në familje” me skenar të shkruar nga gratë që vuajnë dënimin në QKF në Lipjan.
- Që nga vera e vitit 2021, EULEX-i ka finalizuar montimin e filmit të shkurtër me temë “Pasojat e abuzimit me drogën nga të rinjtë”. Koncepti i filmit është bërë nga të miturit që vuajnë dënimin në QK Lipjan dhe është financuar/prodhuar nga EULEX-i.
- NJK ka mbështetur SHKK-në në hartimin e projektligjeve për “Ekzekutimin e Sanksioneve Penale” dhe “Shërbimin Korrektues të Kosovës” dhe akteve nënligjore si, rregulloren për kategorizimin e të burgosurve, menaxhimin e të burgosurve të kategorizuar dhe strukturën e brendshme organizative të SHKK-së”.
- NJK ka qenë pjesë e grupit punues për krijimin e pavijonit për të burgosurit me sëmundje mendore në QK Dubravë.

### 20.3 Këshilli i Evropës

Këshilli i Evropës – Përmes instrumentit Projekti Rajonal Horizontal II tre vjeçar "Përmirësimi i kapaciteteve ndëshkuese në adresimin e radikalizimit në burgjet në Ballkanin Perëndimor dhe Turqin", Kosova dhe SHKK-së në veçanti është përfitues nga ky projekt i keshillit të Evropës.. përfaqësues nga SHKK-së janë duke marr pjesë ne 4 grupe punuese të themeluara sipas këtij projekti dhe kanë përfituar nga forumet shkëmbimi i përvojave ndërmjet shteteve të Ballkanit perëndimor.

Projekti ofron forume për diskutime të hapura dhe shkëmbime sistematike për punonjësit e burgjeve dhe të shërbimit të provës në Ballkanin Perëndimor, duke i dhënë mundësinë të identifikojnë praktikën e mira, të mësojnë nga gabimet dhe të vendosin standarde minimale, të cilat do të rezultojnë në përmirësimin e metodologjisë dhe mjeteve në kuadër të kundërvënies ndaj radikalizimit në burgje dhe në shtimin e përpjekjeve për rehabilitimin e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm



Rezultat i zbatimit të këtij projekti të këshillit të Evropës, SHKK-së është përfitues i një Granti në vlerë 17280 Euro.

**Pilotimi i mjeteve dhe programit specifik për VEP** në Kosovë filloi në maj 2021 dhe do të zgjasë deri në tetor 2021. Ai zhvillohet në dy burgje, përkatësisht në Burgun e Sigurisë së Lartë (BSL) dhe në Burgun e Dubravës. Në përgatitje për fazën pilot, 16 punonjës të Kosovës nga të dy burgjet, si dhe oficerë të shërbimit të provës, u trajnuan në aplikimin e mjeteve dhe programit të veçantë për VEP.

Për ta përmbledhur, pilotimi i mjeteve të VRN-së specifike për VEP (burgosurit për ekstremizëm të dhunshëm) dhe programi po përfundojnë dhe rezultatet e tij do të vlerësohen në periudhën e ardhshme. Vlerësimi afatmesëm i fazës pilot tregoi se personeli i burgjeve të përfshirë ka demonstruar nivel të lartë profesionalizmi dhe përkushtimi për të përfunduar me sukses procesin. Rezultatet e pilotimit të VRN (vlerësimi, nevojat dhe risqet) -së në Dubravë dhe në BSL demonstrojnë se kur ka një kombinim të monitorimit dhe trajnimit në mbështetje të përfituesit, rriten edhe aftësitë, edhe besimi bashkë. Stafi i trajnuar dhe i angazhuar në pilotim ka fituar njohuri dhe aftësi të vlefshme për transferimin e mëtejshëm tek kolegët e tjerë.

Sipas raporteve nga projekti, SHKK-së është vlerësuar një „Shembull i praktikës së mirë në rajon” në adresimin, trajtimin dhe monitorimin e radikalizmit në burgje.

#### **20.4 Nga OJQ Gjermane Help gjatë vitit 2021**

Edhe gjatë vitit 2021 ka vazhduar përkrahja e OJQ Gjermane Help për Shërbimin Korrektues të Kosovës në kuadër të projektit “Mbështetja stabile socio-ekonomike në rajonin e Ballkanit Perëndimor” 2021-2022 i përkrahur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme e Qeverisë Gjermane dhe zbatuar nga Help.

#### **20.5 Bashkëpunimi dhe ndihma nga FSK**

Me datën 26.08.2021 Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë i priti në takim përfaqësuesin e FSK-së dhe bashkëpunëtorët e tij nga Regjimenti i Mbrojtjes Civile- RMC, togerin, Egzon Sylja. Gjatë vizitës, z. Sylja, dhuroi donacion për SHKK-në rreth 2400 copë maska mbrojtëse, të cilat do të përdoren me qëllim mbrojtjen e të dënuarve dhe punonjësve të QP Prishtinë nga Covid-19.

Me datën 27.08.2021 Në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, Forca e Sigurisë së Kosovës dhuroi 2000 copa të maskave mbrojtëse anti Covid-19.

Donacionin e dhuruan oficerët e FSK-së, Shaban Kurti dhe Fidan Dema, ndërsa në emër të QKML-së u pranua nga Zëvendës drejtori i QEKL-se z. Fitim Bërbatovci, i cili gjatë pranimit falënderoi për zemërsisht pjesëtarët e FSK, e në veçanti Komandantin FSK për regjionin e Gjilanit, z. Albert Kuqi, duke vlerësuar lartë kontributin e FSK në shtimin e masave mbrojtëse anti Covid -19 edhe në këtë Qendër.

Gjithashtu edhe më tutje Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK )po vazhdojnë të japin donacione Maska mbrojtëse edhe për Qendrat tjera Korrektuese .

#### **20.6 Bashkupnimi dhe ndihma nga Ambasada Holandez**

Gjithashtu nga Ambasada Holandeze janë pranuar 2 copë vetura per përcjelljen e burgosurve.

#### **20.7 Bashkupnimi dhe ndihma nga AAPSK**

Kemi pranuar donacion nga AAPSK 16 dhe 6 televizor plazma kompjuter te cilët i kemi dhënë ne shfrytëzim Kabinetit te Shkollës ne Q.K Dubrave dhe TV i kemi dhënë ne shfrytëzim tek pavijoni i femrave ne Q.K Lipjan.

## **XV. PJESA E PESËMBËDHJETË**

### **STATISTIKAT**


#### **21. Pranimet e të burgosurve në Institucionet Korrektuese**

Sipas raportimeve nga institucionet korrektuese gjatë periudhës 01.01.2020 deri me 31.12.2020 janë pranuar gjithsejtë **3533** të burgosur nëpër institucionet korrektuese.

Prej tyre kanë qenë: **1086** të Dënuar (madhorë), **21** e Dënuar (Femër), **2224** të Paraburgosur (madhorë), **66** të Paraburgosura (Femra), dhe **94** të Mitur të Paraburgosur, **04** e Paraburgosure Mitur (Femër), **01** i Mitur i Dënuar, **19** të Mitur me Mase Edukative.

*Grafikoni nr.16 i pranimeve të të burgosurve në Institucione Korrektuese- Vitit 2021*





## 22. Lirimet e të burgosurve nga institucionet korrektuese


Gjatë vitit 2021 janë liruar gjithsejtë 3245 të burgosur.

Prej tyre kanë qenë: 1224 të dënuar madhorë, 31 të dënuara (femra), 24 i mitur me masë edukative dhe 1805 të paraburgosur (madhorë), 54 të paraburgosura (Femra) dhe 94 të paraburgosur (të mitur), 05 të dënuar (të mitur), 05 të mitura të Paraburgosur (femra), 01 të mitura të Dënuara (femra), 02 të mitura me Masë Edukative (femra).

*Grafikoni nr.17 i lirimeve të të burgosurve nga institucionet korrektuese – Viti 2021*

**Janar 2021**

### GJITHSEJTË 3245 TË BURGOSUR TË LIRUAR



### 23. Beneficionet e të dënuarve (Pushimet të rregullta dhe jashtë institucioneve korrektuese)

Gjithsejtë : **1292** pushime të rregullta të Burgosurve sipas Institucioneve Korrektuese.

Tabela nr. 18 Lista e pushime të rregullta të burgosurve sipas Institucioneve Korrektuese

QK Dubravë	BSL	QK Smrekonicë	QP Prishtinë	QK Lipjan	QP Mitrovicë	QP Gjilan	QP Prizren	QP Pejë	QEK Lipjan	QKF Lipjan
482	107	364	45	96	49	25	18	05	64	37

Gjithsejtë: **61** pushime të jashtëzakonshme të Burgosurve sipas Institucione Korrektuese

Tabela nr. 19 Lista e vikendeve të Jashtëzakonshëm të dënuarve sipas institucioneve prej 01.01.2021-31.12.2021

QK Dubravë	BSL	QK Smrekonicë	QP Prishtinë	QK Lipjan	QP Mitrovicë	QP Gjilan	QKF Lipjan
01	11	38	01	04	02	01	03

## 24. Statistika e gjetjeve dhe parandalimit të gjërave të ndaluara në Institucionet Korrektuese

Gjatë vitit **2021** në Institucionet Korrektuese janë evidentuar **205** bastisje prej të cilave **161** kanë qenë **gjetje** e kontrabandës dhe **44** tjetër kanë qenë bastisje **parandaluese**.

Tabela nr. 20 Bastisjet (gjetje) sipas institucioneve për Vitin 2021

QK Dubravë	BSL	QK Smrekonicë	QK Lipjan	QEK Lipjan	QP Prishtinë	QP Prizren	QP Pejë	QP Gjilan	QP Mitrovicë
<b>95</b>	<b>03</b>	<b>15</b>	<b>09</b>	<b>01</b>	<b>12</b>	<b>08</b>	<b>06</b>	<b>04</b>	<b>02</b>

Tabela nr. 21 Bastisjet pozitive parandaluese sipas institucioneve për vitin 2021

QK Dubravë	BSL	QK Smrekonicë	QP Prishtinë	QP Prizren	QP Pejë	QP Gjilan	QP Mitrovicë	Total
<b>24</b>	<b>02</b>	<b>01</b>	<b>10</b>	<b>01</b>	<b>01</b>	<b>03</b>	<b>02</b>	<b>44</b>



## 25. Statistika e gjetjes së kontrabandës në sasi

Tabela nr.22 e gjetjes se Kontrabandës

INSTITUCIONI	Telefon	Bateri tel.	Adapter	SIM kartë	Narkotik	Bizë	USB-SD	Kufje	Tjera
QK Dubravë	37	1	18	29	31	14	16	1	25
BSL	1	0	1	1	1	0	1	0	0
QK Smrekonicë	24	9	34	24	0	0	3	4	5
QK Lipjan	0	0	0	0	3	8	0	0	4
QEK Lipjan	0	0	0	0	0	0	1	0	0
QP Prishtinë	9	0	3	5	4	2	7	0	6
QP Gjilan	5	0	1	1	1	1	0	0	1
QP Prizren	10	0	8	5	2	0	2	0	0
QP Pejë	0	0	0	0	0	0	11	0	0
QP Mitrovicë	2	0	0	0	1	2	0	0	1
QKF Lipjan	3	0	3	2	2	1	1	0	0
IPFK	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali -----&gt;</b>	<b>91</b>	<b>10</b>	<b>68</b>	<b>62</b>	<b>45</b>	<b>28</b>	<b>42</b>	<b>5</b>	<b>42</b>

## 26. Incidentet në Institucionet Korrektuese

Tabela nr.22 Incidentet në institucionet korrektuese gjatë Vitit 2021.

INSTITUCIONI	Rrahje	Sulm kërcënim ndaj stafit	Sulm	Vetëëndim	Tentim varje	Varje	Demolim	Zjarrvërje	Fjalosje	Tentim ikje	Largim	Moskthim	Vdekje	Vdekje në Spital	Refuzim mbyllje
QK Dubravë	41	8	5	20	4	0	3	1	8	0	0	2	0	4	14
BSL	11	2	6	1	1	0	3	1	2	0	0	0	0	1	0
QK Smrekonicë	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
QK Lipjan	8	0	2	5	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0
QEK Lipjan	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0
QP Prishtinë	3	1	2	12	7	1	0	0	0	4	0	0	0	1	0
QP Prizren	1	1	0	3	1	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0
QP Pejë	8	0	2	3	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
QP Gjilan	2	5	4	7	0	0	2	0	4	0	0	0	0	0	0
QP Mitrovicë	3	2	0	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
QKF Lipjan	2	2	1	3	3	1	0	3	3	0	0	0	0	0	0
IPFK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Janar 2021

<b>Totali</b>															
	80	21	22	60	17	3	8	05	17	5	3	03	00	06	14

### 27.Grevat e urisë

Brenda Vitit 2021 në grevë urie janë futur **68** (gjashtëdhjetë e tetë) të burgosur, arsyetimet e tyre ishin për pakënaqësi me vendimin e gjykatës, kërkesë për transferim apo pakënaqësi me tretmanin (regjimin) e caktuar.

*Tabela nr.23 Grevat e urisë nga të burgosurit sipas institucioneve për Vitit 2021*

QK Dubravë	BSL	QP Prishtinë	QP Prizren	QP Pejë	QP Gjilan	QKF Lipjan	QP Mitrovicë
24	07	09	02	10	01	01	13

### 28.Instituti i Psikiatrisë Forenzike – IPFK

Në **Institutin Psikiatrisë Forenzike (IPFK)** në QKUK aktualisht janë **(09)** të burgosur të hospitalizuar për trajtim dhe ekzaminim ( meshkuj ).Në IPFK gjatë Vitit 2021 janë bërë **( 53 )** pranime si dhe **(44)** kthime në Institucione Transfere.

Gjithsejtë 1868 lëvizje të të burgosurve nëpër spitale/klinika jashtë Institucioneve Korrektuese.

*Tabela nr.24 Numri i lëvizjeve të të burgosurve sipas Institucioneve*

QK Dubravë	BSL	QK Lipjan	QP Prishtinë	QP Gjilan	QP Prizren	QP Pejë	QP Mitrovicë	QKF Lipjan	QK Smrekonicë	IPFK	QEK Lipjan	Totali
60	8	7	44	25	13	10	13	4	1	3	0	<b>188</b>
42	12	9	32	25	13	16	9	11	1	1	0	<b>171</b>
68	16	14	36	29	21	11	8	14	2	9	2	<b>230</b>
54	8	12	35	31	5	14	7	6	4	1	0	<b>177</b>
55	19	10	36	21	28	14	0	9	8	2	1	<b>203</b>

**Janar 2021**



68	24	23	39	39	16	20	2	18	13	2	1	265
137	25	23	44	44	20	13	19	10	16	2	0	353
112	26	13	58	50	21	19	3	10	17	10	2	341
46	20	12	32	50	20	18	6	18	11	1	1	235
94	23	16	45	50	16	15	9	20	16	0	1	305
108	25	26	60	29	14	20	12	9	33	1	0	337
98	29	10	52	39	27	20	6	8	23	1	0	313
<b>942</b>	<b>235</b>	<b>175</b>	<b>513</b>	<b>432</b>	<b>214</b>	<b>190</b>	<b>94</b>	<b>137</b>	<b>145</b>	<b>33</b>	<b>8</b>	<b>3118</b>

### 29. Largimet dhe mos kthimet nga vikendi

Me datën 08.08.2021 i mituri me masë edukative E.K nuk është kthyer nga vikendi. I mituri ka shkuar në vikend me datën 06.08.2021 dhe është dashtë të kthehet me datën 08.08.2021 në ora 17:00. Është kontaktuar familja e të miturit saktësisht prindi (baba) dhe i njëjti ka deklaruar se i mituri nuk është në shtëpi dhe se ka njoftuar Policin e Kosovës

Me datë 24.08.2021 rreth orës 09:00 i burgosuri që ishte Vikend A.I nga QK Dubravë me datë 22.08.2021 deri me datë 24.08.2021, i burgosuri nuk është kthyer nga vikendi. Personeli i QK Dubravë ka kontaktuar me familjarët e të burgosurit, familjarët kanë deklaruar se i burgosuri është në pushim në bregdet, burgosuri ishte shfrytëzues i vikendeve për të dytën herë.

Me datën 17.10.2021 në QK Lipjan rreth orës 14:45 dy të mitur me masë edukative SH. XH. Dhe A. K. janë larguar nga Institucioni.

Lidhur me ngjarjen janë informuar Drejtoria e burgut, Drejtoria Qendrore, Policia e Kosovës. Në ora 17:34 Policia e Kosovës i ka sjellë që të dy të miturit e larguar pasi që i ka ri arrestuar.

Me datën 17.10.2021 nga QK Dubravë i burgosuri E. Sh i cili ishte në pushim ( vikend ) të rregullt nga data 15.10.2021 dhe me datën 17.10.2021 është dashur të kthehet në QK Dubravë në ora 15:00, mirëpo i burgosuri nuk është kthyer nga pushimi (Vikendi).

I burgosuri ishte shfrytëzues i rregullte i pushimit (vikendit).

Me datën 21.12.2021 në ora 11:09 kemi marre njoftim nga oficeri i njësitit të transportit Ilir Nimanaj që i paraburgosuri D.E ,nr-QP-PE:000185/2021 i akuzuar për vrasje ne tentative, ka arritur që të arratiset ,para hyrjes se prokurorisë dukë vrapuar me pranga ne duar. Në ora 11:10 është njoftuar policia që ka dërguar njësitet relevante ne lokacion dhe pas një aksioni te përbashkët ne ora 11:32 është konfirmuar kapja e personit te arratisur dhe vendosja e tij nen kontroll te plote.



## **XVI. PJESA E GJASHTËMBËDHJETË**

### **PËRKUJDESJA SHËNDETSORE**

Shërbimi Shëndetësor në institucione korrektues ofrohet nga Ministria e Shëndetësisë.

- Që nga viti 2013 në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë Shëndetësisë lidhur me ofrimin e kujdesit shëndetësor për të burgosur në institucione korrektuese është lidhur marrëveshje bashkëpunimi për transferimin e kompetencave nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë.
- Gjatë vitit 2021 ofrimi i përkujdesjes shëndetësore është realizuar në nivelin e kënaqshëm falë bashkëpunimit në mes SHKK-së dhe Departamentit Shëndetësor të Burgjeve, me theks të veçantë menaxhimi i pandemisë COVID-19.

## XVII PJESA E SHTATËMBËDHJETË

### Menaxhimi i Pandemisë Covid 19 në Institucionet Korrektuese

Që nga marsi i vitit 2020 dhe përgjatë vitit 2021, Shërbimi Korrektues i Kosovës është ballafaquar me pandeminë, e cila ka përfshirë tërë Botën, por edhe Republikën e Kosovës, falë masave të ndërmarra dhe angazhimit maksimal të stafit të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Departamentin Shëndetësor të Burgjeve, kemi arritur që pandeminë në institucione të menaxhojmë me një profesionalizëm të lartë dhe përkujdesje të vazhdueshme për jetën e të burgosurve dhe stafit.

Institucionet janë furnizuar në vazhdimësi me masa dhe pajisje mbrojtëse me qëllim të parandalimit të pandemisë Covid 19, duke bërë kështu që numri i të infektuarve tek të burgosurit të jetë minimal dhe po ashtu edhe tek stafi.

Me qëllim të menaxhimit sa më të mirë të kësaj situate të krijuar, SHKK ka nxjerr urdhra operativ, si në vijim:

Urdhrat operativ:

9.1 Me datën 20.08.2021, hyn në fuqi Plani i Ri Operativ për masat Kundër COVID-19, i protokolluar me datë 20.08.2021 me numër rendor 0969.

9.2 URDHËR OPERATIV Masat lehtësues Covid-19 Gjatë muajit Shtatorë ka vazhduar plani operativë për masat mbrojtës kundër virusit Covid-19, i cili ka hyr në fuqi me datën 28.09.2021 me numër rendor të Protokollit 1096. Duke filluar nga data 28.09.2021, lejohen vizitat familjare për të burgosur, vizitat e lira në lokale të veçanta. Masat lehtësuese për vizitat familjare, Shërbimi Korrektues ka marr vendim që ti zbus masat : në fazën e parë lejohen vetëm një vizitor që ta vizitoj të burgosurin, familjarët duhen ti respektojnë masat e nxjerra me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës:

- Vizitat familjare të mbahen në distancë maska të jetë e vendosur gjatë gjithë kohës.
- Vizitat e lira në lokale të veçanta, a. Vizitorët duhen të dëshmojnë Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e plotë ose të një doze të vaksinës kundër Covid-19 17 b. Testi RT-PCR negativ për Covid-19, jo më i vjetër se 72 orë c. Test i shpejtë antigjenë negativ jo më i vjetër se 48 orë • Po ashtu do të fillohet me Transferet e brendshme për të burgosur

9.3 URDHËR OPERATIV Masat lehtësues Covid-19 Gjatë muajit Tetor ne baze te planit operativë janë lehtësuar masat për te burgosurit ku ju është lejuar qe familjaret te vizitojnë te burgosurin me dy persona te rritur dhe dy fëmijë, urdhër operativ me nr. 1201 i datës 26.10.2021. Duke filluar nga data 28.10.2021, lejohen vizitat familjare për të burgosur, është rritur numri i vizitorëve 2+2 (02 të rritur, 02 fëmijë).

9.4 Masat lehtësuese për vizitat familjare, Shërbimi Korrektues ka marr vendim që ti zbus masat : në fazën e parë lejohen vetëm 2+2 vizitor që ta vizitoj të burgosurin, familjarët

duhen ti respektojnë masat e aplikueshme me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës:

- Vizitat familjare të mbahen në distancë maska të jetë e vendosur gjatë gjithë kohës.
- Vizitat e lira në lokale të veçanta, a. Vizitorët duhen të dëshmojnë Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e plotë ose të një doze të vaksinës kundër Covid-19 b. Testi RT-PCR negativ për Covid-19, jo më i vjetër se 72 orë c. Test i shpejtë antigenë negativ jo më i vjetër se 48 orë
- Po ashtu do të fillohet me Transferet e brendshme për të burgosur.




### 30. Sfidat e Vitit 2021

Shërbimi Korrektues i Kosovës gjatë vitit është përballuar edhe me sfida të ndryshme të natyrës specifike të punës që ngadalësojnë arritjen e qëllimeve dhe synimeve për zhvillim të SHKK-së:

- Buxheti i pamjaftueshëm vjetor për fushën e ESP dhe SHKK-së;
- Mungesa e ligjit të veçantë për natyrën dhe specifikat e punës të SHKK-së deri në miratimin e tij nga institucionet kompetente të Republikës së Kosovës;
- Mosmiratimi i LESP të rishikuar në të cilin parashihen të zgjerohen beneficionet për të dënuar;
- Ballafaqimi me situatën e krijuar nga pandemia covid-19.

Raporti përmbillet në fletën 70 të këtij dokumenti.

Prishtinë, datë 22/02/2022



Ali Gashi

Zëvendësues i Drejtor të Përgjithshëm

Shërbimi Korrektues i Kosovës